



**Vlerësim i Rolit të Institucioneve të Pavarura në Reformën e  
Sektorit të Sigurisë  
në Shqipëri**

**Arjan Dyrmishi  
Besjana Kuçi  
Egest Gjokutaj**

**Nëntor 2011**

*Ky studim është mbështetur nga Fondacioni Konrad-Adenauer-Stiftung  
dhe  
Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura*

## Përmbajtja e Lëndës

<b>Lista e Shkurtimeve</b> .....	3
<b>1. Hyrje</b> .....	4
<b>2. Mbikëqyrja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut</b> .....	5
<b>2.1. Avokati i Popullit</b> .....	6
2.1.1. <i>Themelimi</i> .....	6
2.1.2. <i>Kuadri Kushtetues dhe Ligjor</i> .....	6
2.1.2.1. <i>Mandati</i> .....	6
2.1.2.2. <i>Pavarësia</i> .....	7
2.1.2.3. <i>Juridiksioni mbi Sektorin e Sigurisë</i> .....	7
2.1.2.4. <i>Implementimi i Legjislacionit</i> .....	8
2.1.3. <i>Performanca e institucionit të AP-së</i> .....	8
2.1.4. <i>Kontributi dhe Sfidat</i> .....	11
2.1.4.1. <i>E drejta për informim mbi dokumentet zyrtarë</i> .....	11
2.1.4.2. <i>Marrëdhënia me institucionet e tjera dhe publikun</i> .....	11
<b>2.2. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</b> .....	12
2.2.1. <i>Themelimi dhe trashëgimia nga Avokati i Popullit</i> .....	12
2.2.1.1. <i>Mbrojtja e të dhënave Personale përpara vitit 2008</i> .....	13
2.2.2. <i>Mandati, Kompetencat dhe juridiksioni</i> .....	14
2.2.3. <i>Pavarësia dhe Burimet</i> .....	14
2.2.4. <i>Performanca dhe Zbatimi</i> .....	14
<b>2.3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi</b> .....	15
2.3.1. <i>Themelimi dhe kuadri ligjor</i> .....	15
2.3.2. <i>Kapacitetet</i> .....	17
2.3.3. <i>Performanca</i> .....	17
2.3.4. <i>Kontributet dhe sfidat</i> .....	17
<b>3. Kontrolli i buxhetit të shtetit, prokurimeve dhe korrupsionit</b> .....	18
<b>3.1. Kontrolli i Lartë i Shtetit</b> .....	18
3.1.1. <i>Themelimi</i> .....	18
3.1.2. <i>Kuadri Kushtetues dhe Ligjor</i> .....	19
3.1.2.1. <i>Mandati</i> .....	19
3.1.2.2. <i>Pavarësia</i> .....	20
3.1.2.3. <i>Juridiksioni mbi institucionet e sektorit të sigurisë</i> .....	20

3.1.2.4. Zbatimi i Legjislacionit.....	20
3.1.3. Performanca.....	21
<b>3.2. Avokati i Prokurimeve.....</b>	<b>23</b>
3.2.1. Themelimi dhe kuadri ligjor .....	23
3.2.2. Kapacitetet.....	24
3.2.3. Performanca.....	25
3.2.4. Arritjet Kontributet dhe sfidat .....	25
<b>3.3. Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive.....</b>	<b>26</b>
3.3.1. Themelimi.....	27
3.3.2. Kuadri ligjor.....	27
3.3.2.1. Mandati.....	27
3.3.2.2. Pavarësia.....	28
3.3.2.3. Juridiksioni mbi institucionet e sektorit të sigurisë.....	28
3.3.3. Kapacitetet.....	28
3.3.4 Performanca dhe zbatimi i legjislacionit.....	29
3.3.5. Arritjet Kontributet dhe sfidat.....	30
<b>4. Konkluzione.....</b>	<b>32</b>
<b>5. Rekomandime.....</b>	<b>34</b>
<b>6. Bibliografia.....</b>	<b>36</b>

## Lista e Shkurtimeve

<b>AK</b>	Autoritetet Kontraktore
<b>AP</b>	Avokati i Popullit
<b>AuP</b>	Autoritetet Përgjegjëse
<b>AvP</b>	Avokati i Prokurimeve
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>DCAF</b>	Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces
<b>DSIK</b>	Drejtoria për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar
<b>FA</b>	Forcat e Armatosura
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>ILKDP</b>	Inspektorati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive
<b>IP</b>	Inspektori i Përgjithshëm
<b>IPM</b>	Institucionet e Pavarura të Mbikëqyrjes
<b>KÇLAPDNj</b>	Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
<b>KEF</b>	Komisioni për Ekonominë dhe Financat
<b>KMD</b>	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
<b>KMDhP</b>	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
<b>KSK</b>	Komisioni për Sigurinë Kombëtare
<b>LMD</b>	Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi
<b>LPP</b>	Ligji për Prokurimet Publike
<b>MB</b>	Ministria e Brendshme
<b>MM</b>	Ministria e Mbrojtjes
<b>MPQM</b>	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
<b>NATO</b>	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
<b>NjIF</b>	Njësia e Inteligjencës Financiare
<b>OSBE</b>	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
<b>PSh</b>	Policia e Shtetit
<b>PShKMI</b>	Protokolli Shtesë për Mbrojtjen e Individëve
<b>ShiSh</b>	Shërbimi Informativ Shtetëror

# 1. Hyrje

Ky punim kërkimor analizon Institucionet e Pavarura të Mbikëqyrjes (IPM) në Shqipëri.<sup>1</sup> IPM, në kuptimin e këtij studimi, janë ato institucione të cilat krijohen nga Kuvendi dhe raportojnë përpara tij. Ato përbëjnë një pjesë kryesore të qeverisjes demokratike të sektorit të sigurisë. Së bashku me pushtetin ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësorin IPM kontribuojnë për mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë nga institucionet civile të zgjedhura në mënyrë demokratike.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë performancën e IPM duke u përqendruar në rolin që ato luajnë si pjesë e sistemit të llogaridhënies së institucioneve të sektorit të sigurisë. Studimi i adresohet kryesisht institucioneve vendimmarrëse shqiptare, por edhe shoqërisë civile, qarqeve akademike, medias dhe donatorëve të huaj.

Kjo punë kërkimore analizon IPM duke u përqendruar tek fusha e mandatit të tyre, kuadri ligjor me anë të të cilit janë krijuar dhe funksionojnë, burimet që IPM kanë në dispozicion si dhe marrëdhëniet e këtyre institucioneve me institucionet e sektorit të sigurisë, Qeverinë, Kuvendin dhe publikun. Duke pasur parasysh rëndësinë e ‘pavarësisë’ për punën e këtyre institucioneve, studimi i kushton vëmendje të veçantë këtij elementi.

Institucionet e Pavarura të Mbikëqyrjes që analizohen nga ky studim janë:

- Avokati i Popullit (AP)
- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDhP)
- Komisioneri i Mbrojtjes nga Diskriminimi (KMD)
- Kontrolli i Lartë të Shtetit (KLSH)
- Inspektoriat i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive (ILKDP)
- Avokati i Prokurimeve (AvP)

Numri në rritje i IPM në vitet e fundit, tregon nivelin e lartë të besimit që Kuvendi i Shqipërisë ka krijuar ndaj këtyre institucioneve duke iu deleguar kontrollin e zbatimit të ligjeve të miratuara prej tij. Megjithatë, deri më sot nuk ka një vlerësim të pavarur mbi performancën e IPM, i cili do të mund të hidhte dritë mbi nivelin se deri ku kjo tendencë justifikohet. Në përpjekje për të mbushur këtë boshllëk, ky studim analizon IPM nga perspektiva e shoqërisë civile, duke u përqendruar veçanërisht tek roli që këto struktura kanë luajtur dhe luajnë në mbikëqyrjen dhe kontrollin e institucioneve të sektorit të sigurisë.

Studimi bazohet në analizën e kuadrit ligjor, kapaciteteve dhe ekspertizës, pavarësisë së IPM si dhe tek marrëdhëniet e tyre me institucionet e sektorit të sigurisë, ekzekutivin dhe Kuvendin.

---

<sup>1</sup> Pjesë të këtij publikimi janë zhvilluar në kuadër të projektit studimor: “Ndërtimi i kapaciteteve të Shoqërisë Civile për identifikimin dhe monitorimin e reformës së sektorit të sigurisë në Ballkanin Perëndimor”. Ky projekt rajonal përfshiu 7 institute kërkimore (*think tank*) nga: Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia dhe u zhvillua në bashkëpunim me *Geneva Centre for the Democratic Control of the Armed Forces (DCAF)* ([www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)). Metodologjia për identifikimin dhe monitorimin e reformës së sektorit të sigurisë u zhvillua nga *Belgrade Centre for Security Policy* ([www.ccmr-bg.org](http://www.ccmr-bg.org)). Projekti u mbështet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë se në përgjithësi kuadri ligjor për funksionimin e IPM është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe i lejon ato që të përmbushin detyrat e tyre. Megjithatë, niveli i pavarësisë i disa IPM dhe mandati i tyre në lidhje me institucionet e sektorit të sigurisë duket se është i dobët. Nevojiten përmirësime të mëtejshme për të mundësuar zbatimin më efektiv të legjislacionit ekzistues. Përgjithësisht, institucionet e sektorit të sigurisë nuk krijojnë pengesa ndaj aktivitetit të IPM dhe zbatojnë rekomandimet e tyre. Pavarësisht kësaj, ende ekzistojnë rekomandime të cilat ose lihen pas dore ose zvarriten nëpërmjet procedurash burokratike.

IPM financohen nga buxheti i shtetit dhe zotërojnë burimet njerëzore dhe materiale të nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre. Megjithatë, gati të gjithë këto institucione theksojnë se buxhetet e tyre janë tkurrur dhe se burimet njerëzore që kanë në dispozicion janë të pa mjaftueshme për t'i lejuar ata që të përmbushin detyrat që u përcakton ligji në mënyrë efektive.

Përgjithësisht, efikasiteti i IPM përcaktohet nga shkalla e konsolidimit institucional të tyre. Institucionet më të vjetër përqendrohen më së shumti në përmbushjen e mandatit të tyre, ndërsa IPM e krijuara së fundmi përqendrohen përgjithësisht tek ndërtimi i kapaciteteve.

Të gjithë IPM raportojnë rregullisht në Kuvend dhe raportet diskutohen në komisionet parlamentare respektive. Megjithatë, Kuvendi mund dhe duhet të bëjë më shumë për të ndihmuar IPM që të përmbushin më së miri mandatet e tyre. Sfidat kryesore me të cilën përballen IPM janë politizimi dhe tendenca për dobësimin e pavarësisë së këtyre institucioneve.

Për zhvillimin e këtij studimi u analizua legjislacioni përkatës, raportet e IPM në Kuvend, dokumente parlamentare, informacion i marrë nga IPM me anë të pyetjeve dërguar pranë tyre, raporte të medias dhe të organizatave ndërkombëtare, si dhe intervista dhe fokus grupe. Pavarësisht gatishmërisë të IPM për të kontribuar në këtë studim, informacioni i ofruar prej tyre ishte kryesisht sipërfaqësor.

Seksioni në vijim analizon IPM që mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Seksioni i dytë analizon IPM të cilat mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit mbi buxhetin, prokurimet dhe luftën kundër korrupsionit. Seksioni i fundit, paraqet konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të IPM.

## **2. Mbikëqyrja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut**

Ky seksion analizon IPM që kontrollojnë zbatimin e legjislacionit që mbron të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve në Shqipëri. Institucioni i parë që trajtohet është Avokati i Popullit, ndjekur nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nga Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit.

## 2.1. Avokati i Popullit

Ky seksion analizon institucionin e Avokatit të Popullit (AP). Vëmendje e veçantë i kushtohet analizës së kushteve që çuan në themelimin e AP, mandatit kushtetues dhe detyrave e tjera që i janë dhënë këtij institucioni nga legjislacioni përkatës, pavarësisht së AP, juridiksionit dhe aksesit të tij në sektorin e sigurisë, zbatimin e legjislacionit, performancën e institucionit, të drejtën për informim mbi dokumentet zyrtare dhe së fundmi marrëdhëniet e AP me institucione të tjerë dhe me publikun.

### 2.1.1. Themelimi

Shkelja sistematike e të drejtave të njeriut në Shqipëri gjatë komunizmit dhe vështirësitë për të mundur mbrojtjen e plotë të tyre përgjatë viteve të hershëm të post-komunizmit, nxorën në pah nevojën për hartimin dhe miratimin e një kuadri të ri.<sup>2</sup> Prandaj, Kushtetuta e vitit 1998 i kushtoi vëmendje të veçantë mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe themeloi AP si institucionin kryesor për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në këtë fushë.

Kreu i VI i Kushtetutës përcakton mandatin, pavarësinë dhe juridiksionin e institucionit të AP.<sup>3</sup> Ligji për AP u miratua në vitin 1999 dhe përmirësime të mëtejshme të tij janë bërë gjatë viteve 2000 dhe 2005. Avokati i Popullit i parë u zgjodh në shkurt të vitit 2000, datë që shënoi edhe fillimin e aktivitetit të këtij institucioni. Pjesëmarrja e 15 kandidatëve në procesin zgjedhor të AP të parë tregonte rëndësinë e madhe që i kushtohej këtij institucioni të ri nga aktorët politikë dhe shoqëria.<sup>4</sup>

Një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe komuniteti ndërkombëtar i cili mundësoi këshilla dhe mbështetje të vazhdueshme. OSBE, Këshilli i Evropës dhe disa vende të veçanta kanë qenë mbështetës aktivë të themelimit dhe institucionalizimit të AP. Veçanërisht Danimarka, ka dhënë mbështetje të konsiderueshme financiare dhe ekspertizë e cila ndihmoi për procesin e themelimit dhe konsolidimit të institucionit të AP gjatë viteve të para.<sup>5</sup>

### 2.1.2. Kuadri Kushtetues dhe Ligjor

#### 2.1.2.1. Mandati

Misioni i AP është “të mbrojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.”<sup>6</sup> Përveç mandatit të mundur nga Kushtetuta dhe ligji organik,<sup>7</sup> detyra të tjera i

---

<sup>2</sup> Shih Human Rights Watch, “Raporti për Shqipërinë, 1996” dhe, Human Rights Watch, “Raporti për Shqipërinë, 1997”, [www.hrw.org](http://www.hrw.org)

<sup>3</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 134

<sup>4</sup> Avokati i Popullit, “Raporti Vjetor në Parlament, 2000”

<sup>5</sup> Avokati i Popullit, “Avokati i Popullit në Shqipëri, 2003” [www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/AP.pdf](http://www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/AP.pdf)

<sup>6</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Pjesa II, Kreu VI, Neni 60.

janë caktuar AP me anë ligjesh të tjerë. Në këtë mënyrë AP është përgjegjës gjithashtu për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare<sup>8</sup> dhe ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve.<sup>9</sup> Deri në vitin 2008, AP ka qenë përgjegjës edhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.<sup>10</sup>

### *2.1.2.2. Pavarësia*

Kushtetuta thekson se AP ka pavarësi të plotë gjatë ushtrimit të detyrave të tij. Avokati i Popullit zgjidhet nga Kuvendi me tre të pestat e deputetëve të tij. Ai mund të shkarkohet nga detyra vetëm pas një propozimi të motivuar dhe të firmosur nga jo më pak se një e treta e deputetëve i cili duhet të votohet nga tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit. AP ka imunitet nga hetimi dhe gëzon të njëjtat privilegje si anëtarët e Gjykatës së Lartë.<sup>11</sup> Në përpjekje për të forcuar pavarësinë e tij, AP i ndalohet të marrë pjesë në parti politike ose të zhvillojë aktivitete politike. Gjatë zhvillimit të detyrave të tij/saj, AP raporton vetëm përpara Kuvendit.<sup>12</sup> Për të siguruar pavarësinë e tij të plotë, AP propozon buxhetin e tij të veçantë i cili miratohet nga Kuvendi.<sup>13</sup>

### *2.1.2.3. Juridiksioni mbi sektorin e sigurisë*

AP ushtron funksionin e tij mbi të gjithë institucionet shtetërorë me përjashtim të Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit.<sup>14</sup> Vendimet dhe urdhrat me karakter ushtarak të forcave të armatosura janë gjithashtu të përjashtuara nga juridiksioni i AP.<sup>15</sup>

Ligji për AP përmban një sërë dispozitash që lehtësojnë mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Së pari, ai mundëson themelimin e një seksioni përgjegjës për mbikëqyrjen e policisë, shërbimeve sekrete, burgjeve, forcave të armatosura dhe pushtetit gjyqësor.<sup>16</sup> Seksioni në fjalë kryesohet nga tre komisionerë të zgjedhur nga Kuvendi. Së dyti, gjatë një hetimi administrativ, AP i garantohet e drejta për të hyrë pa kufizime në mjediset e institucionit të hetuar, për të kontaktuar të gjithë stafin e nevojshëm si edhe të gjithë personat e tjerë që nuk gëzojnë imunitet nga hetimi.<sup>17</sup> Së treti, në rast mos-bashkëpunimi me kërkesën e AP, ky institucion mund të fillojë një procedurë administrative, të propozojë sanksione për nëpunësit civilë, ose t'i propozojë Kuvendit ndërmarrjen e masave specifike.<sup>18</sup> Së katërti, AP mund të rekomandojë përmirësimin ose anulimin e legjislacionit

---

<sup>7</sup> Ligj Nr. 8454, datë 04.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me Ligj Nr. 8600, datë 10.4.2000, dhe Ligj Nr. 9398, datë 12.5.2005.

<sup>8</sup> Ligj Nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare", Neni 18

<sup>9</sup> Ligj Nr. 9888, datë 10.3.2008, "Për disa Ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8328, datë 1.4.1998 për të drejtat dhe trajtimin e të Dënuarve"

<sup>10</sup> Që nga viti 2008 kjo detyrë mbulohet nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

<sup>11</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 61

<sup>12</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 63

<sup>13</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 60

<sup>14</sup> Ligji për AP, Neni 25

<sup>15</sup> Ligji për AP, Neni 25

<sup>16</sup> Ligji për AP, Neni 31

<sup>17</sup> Ligji për AP, Nenet 19,19/1, 20

<sup>18</sup> Ligji për AP, Nenet 22/1, 23



dhe akteve të tjerë normative nëse ato konsiderohen se çojnë në shkeljen e të drejtave të njeriut.<sup>19</sup>

#### *2.1.2.4 Zbatimi i Legjislacionit*

Që prej themelimit të institucionit të AP janë zhvilluar dy procese zgjedhorë të titullarit të institucionit ku i njëjti person është rizgjedhur.<sup>20</sup> Që prej shkurtit të vitit 2010, pozicioni i AP ka qenë vakant. Për shkak të ngërçit politik, që prej vitit 2009, Kuvendi nuk ka mundur të krijojë shumicën e cilësuar që nevojitet për zgjedhjen e Avokatin të Popullit.

AP ka raportuar rregullisht çdo vit në Kuvend përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KÇLAPDNj). Raportet mbulojnë në detaje aktivitetin e AP dhe mbikëqyrja e institucioneve të sektorit të sigurisë zë një pjesë të konsiderueshme të tyre.

Raportet vjetorë të analizuar për këtë studim, nxjerrin në pah pak ose aspak probleme lidhur me zbatimin e legjislacionit nga institucionet e sektorit të sigurisë dhe ekzekutivi. Raportet nuk diskutojnë ndonjë problem për aksesin e AP në institucionet e sektorit të sigurisë duke përfshirë mjediset, dokumentet dhe personelin përkatës. Analizimi i raporteve tregon se niveli i pranueshmërisë të rekomandimeve të AP nga institucionet e sektorit të sigurisë është relativisht i lartë.

AP ka një staf prej 48 personash duke përfshirë 5 ekspertë të të drejtave të njeriut që drejtojnë Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës.<sup>21</sup> Institucioni ka qenë i aftë të rekrutojë një personel të mirë-arsimuar dhe përveç kësaj ka mundur vazhdimisht hapësira për trajnimin në detyrë të stafit të tij. Megjithatë, numri i personelit konsiderohet si i pamjaftueshëm nga AP.<sup>22</sup> Raporti nxjerr në pah se AP është i kënaqur me mjediset e punës të cilat ofrojnë kushtet e duhura për personelin.<sup>23</sup>

#### *2.1.3 Performanca e institucionit të AP*

Për të vlerësuar performancën AP janë studiuar raportet e institucionit përpara Kuvendit për periudhën 2000-2010, dokumentet parlamentarë, pyetjet që i janë dërguar këtij institucioni dhe intervistat.

Siç tregohet nga grafiku, AP ka trajtuar një numër të madh çështjesh që përfshijnë institucionet e sektorit të sigurisë (Grafiku 1).

Institucionet me numër më të madh çështjesh janë Policia dhe Burgjet të ndjekura nga Forcat e Armatosura (FA). Numri i rasteve që përfshijnë shërbimet informative është

---

<sup>19</sup> Ligji për AP, Neni 24


<sup>20</sup> Ermir Dobjani ka shërbyer për dy mandate radhazi si Avokat i Popullit nga shkurti i vitit 2000 deri në shkurt të vitit 2010.

<sup>21</sup> Avokati i Popullit, "Raport Vjetor në Kuvend, 2010"

<sup>22</sup> Diskutim në Fokus Grup me përfaqësuesit e IPM, 13 tetor 2011.

<sup>23</sup> Avokati i Popullit, "Raport Vjetor në Kuvend, 2009"

minimal edhe pse raportet përmbajnë vetëm çështje që lidhen me Shërbimin Informativ Shtetëror (ShISH), por jo të shërbimeve të tjerë informativë.<sup>24</sup>




*Grafiku 1: Numri i çështjeve të adresuara nga AP që lidhen me institucionet e sigurisë. Burimi: Të dhëna nga raportet e AP në Kuvend.*

Me gjithë ndryshimet që vërehen në rastet e trajtuara në vite të ndryshme, mesatarja e rasteve të trajtuara është konstante gjatë gjithë periudhës së analizuar. Është e vështirë që të nxirret ndonjë konkluzion thjesht mbi interpretimin e këtyre të dhënave, por në terma afatgjatë krijimi i një mjedisi të favorshëm për respektimin e të drejtave të njeriut duhet të kishte çuar në një ulje progresive të numrit të çështjeve të raportuara tek AP. Nga ana tjetër, numri i lartë i rasteve të raportuara tek AP tregon besimin që qytetarët kanë tek ky institucion. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se jo të gjithë rastet e trajtuara në raportet e AP lidhen me shkeljen e të drejtave të njeriut. Përveç rasteve që përfshijnë dhunën policore, aksesin e pa autorizuar në mjedise, ndalimin në kundërshtim me ligjin dhe trajtimin jo-njerëzor gjatë izolimit, rastet e raportuara nga AP përfshijnë gjithashtu edhe mosmarrëveshje lidhur me vendin e punës, pagën dhe mosmarrëveshje lidhur me ndihmën ekonomike dhe pensionet, etj, të cilat janë me shumë mosmarrëveshje administrative se sa shkelje të të drejtave themelore.

AP ka nxjerrë një sërë rekomandimesh për përmirësimin e legjislacionit ose të akteve të tjerë normativë si dhe për adresimin e rasteve specifike. Që prej krijimit të këtij institucioni, gati 80% e rekomandimeve të nxjerra prej AP janë marrë në konsideratë nga

<sup>24</sup> Raportet nuk përmbajnë raste që lidhen me Shërbimin Informativ Ushtarak (SHIU) ose me shërbimet e tjera informativë.

institucionet e sigurisë, ekzekutivi dhe Kuvendi.<sup>25</sup> Rekomandimet e lëshuara gjatë periudhës dhjetëvjeçare për ushtrinë, policinë dhe shërbimet informative tregohen në grafikun e mëposhtëm (Grafiku 2).



*Grafiku 2: Numri i çështjeve të adresuara nga AP që lidhen me institucionet e sigurisë. Burimi: Të dhëna nga raportet e AP në Kuvend.*

Një fushë ku raportet e AP nuk tregojnë ndonjë aktivitet të dukshëm dhe e cila dyshohet se çon në shkeljen e të drejtave të njeriut është kontrolli i ligjshmërisë së operacioneve që zhvillohen nga Policia, Prokuroria dhe Shërbimet Informative. Përdorimi i teknikave speciale të hetimit si përgjimi i telekomunikacionit është diskutuar gjerësisht edhe nga media. Në vitin 2007, Prokurori i Përgjithshëm ka raportuar një numër të madh përgjimesh të kryera nga policia dhe shërbimet informative,<sup>26</sup> ndërsa në vitin 2009 Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka ngritur të njëjtën çështje dhe ka propozuar ndryshimin e ligjit për përgjimet e telekomunikacioneve.<sup>27</sup> Megjithatë, AP nuk ka raportuar për ndonjë hetim as edhe ka nxjerrë ndonjë rekomandim për të adresuar këto çështje.

#### 2.1.4. Kontributet dhe Sfidat

##### *2.1.4.1. E drejta për informim për dokumentet zyrtare*

<sup>25</sup> Diskutim në Fokus Grup me përfaqësuesit e IPM, 13 tetor 2011.

<sup>26</sup> Rama, A. "Sollaku: Shqipëria të njëjtin numër përgjimesh si ShBA." *Gazeta Shekulli*, 13 mars 2007. <http://www.shekulli.com.al/news/45/ARTICLE/6270/2007-03-13.html>. Parë në janar 2011.

<sup>27</sup> "Spahiu: Ndryshimet në ligjin mbi përgjimet" *Gazeta Koha Jonë*, 14 shkurt 2009. [http://www.kohajone.com/html/artikull\\_37663.html](http://www.kohajone.com/html/artikull_37663.html). Parë në janar 2011

Kontrulli për zbatimin e legjislacionit për të drejtën e aksesit tek dokumentet zyrtarë është një fushë tjetër ku AP nuk ka qenë dhe aq efikas. Kushtetuta garanton të drejtën për akses në informacionin zyrtar duke theksuar se: “secili ka të drejtën që në përputhje me ligjin, të marrë informacion lidhur me aktivitetin e institucioneve shtetërore”.<sup>28</sup> Kjo e drejtë thelbësore rregullohet nga ligji për të drejtën për informimin për dokumentet zyrtarë dhe AP është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të tij.<sup>29</sup> Siç raportohet nga vetë AP, ligji është zbatuar dobët për një sërë arsyes, kryesisht të lidhura me njohurinë dhe performancën e dobët të administratës publike.<sup>30</sup> Që prej vitit 2007, AP i ka rekomanduar qeverisë një rregullore tip për përdorim nga të gjithë institucionet shtetërore gjatë zbatimit të legjislacionit për të drejtën për t’u informuar, por ajo ende nuk është miratuar.<sup>31</sup> Megjithatë, asnjë sanksion administrativ nuk është ndërmarrë nga AP kundër nëpunësve civilë ose zyrtarëve të tjerë të administratës publike mbi këtë çështje sipas ligjit.<sup>32</sup>

#### 2.1.4.2. Marrëdhëniet me institucionet e tjera dhe me publikun

Performanca e institucionit të AP nuk mund të shihet si e shkëputur nga qëndrimi i institucioneve të sigurisë që mbikëqyren prej tij. Deri tani AP ka vendosur marrëdhënie të mira pune me institucionet e sigurisë të cilët bashkëpunojnë plotësisht me kërkesat e tij gjatë hetimit të rasteve.<sup>33</sup>

Si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i institucionit të AP, Kuvendi luan rol kryesor në formësimin e aktivitetit të këtij institucionit. AP raporton në mënyrë vjetore përpara Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, por AP ka raportuar gjithashtu edhe në seanca plenare. Kuvendi vlerëson raportet me anë rezolutash që miratohen në seanca plenare. Megjithatë, siç del nga analiza e seancave dëgjimore në komision, anëtarët e komisionit nuk shqyrtojnë në detaje respektimin e të drejtave të njeriut nga institucionet e sigurisë, kështu që procesi në tërësi ka pasur prirje të marrë karakter formal.<sup>34</sup> Rezolutat thjesht: “i bëjnë thirrje administratës publike” ose “nxitin AP”, por nuk ekziston vullneti nga ana e Kuvendit për ndërmarrjen e veprimeve konkretë në mbështetje të aktivitetit të AP dhe njëkohësisht zbatimit të ligjeve të miratuara nga vetë Kuvendi.<sup>35</sup> Qasja formale është e dukshme edhe në koordinimin e dobët ndërmjet dy komisioneve të përhershëm që merren drejtpërdrejt ose indirekt me mbikëqyrjen e institucioneve të sektorit të sigurisë: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën

<sup>28</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Kapitulli II: Të Drejtat dhe Liritë Personale, Neni 23

<sup>29</sup> Ligj Nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” Neni 18.

<sup>30</sup> Avokati i Popullit, “Raport Vjetor në Kuvend, 2011”, 8

<sup>31</sup> Avokati i Popullit, “Raport Vjetor në Kuvend, 2010”

<sup>32</sup> Ligji për AP, Nenet 22, 22/1, 23

<sup>33</sup> Intervistë me Artur Lazebue, Shef i Kabinetit i AP-së

<sup>34</sup> Shënime nga raporti i AP në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për vitet, 2008, 2009, 2010. [http://www.parlament.al/web/Procesverbalet\\_10044\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Procesverbalet_10044_1.php). Parë në gusht 2011.

<sup>35</sup> Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për Vlerësimin e aktivitetit të AP për vitin 2004”; Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për Vlerësimin e aktivitetit të AP për vitin 2005”; Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për Vlerësimin e aktivitetit të AP për vitin 2006”; Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për Vlerësimin e aktivitetit të AP për vitin 2007”; Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për Vlerësimin e aktivitetit të AP për vitin 2008”; Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për Vlerësimin e aktivitetit të AP për vitin 2010” [http://www.avokatipopullit.gov.al/?page\\_id=259](http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259). Parë në gusht 2011.

Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KÇLAPDNj) dhe Komisionit për Sigurinë Kombëtare (KSK). I pari prej tyre mbikëqyr ligjshmërinë e veprimeve të institucioneve të sigurisë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, ndërsa i dyti mbikëqyr performancën e institucioneve të sektorit të sigurisë gjatë përmbushjes së detyrave të tyre. Pavarësisht lidhjes së dukshme, AP nuk është ftuar ndonjëherë në seancat dëgjimore të raporteve të institucioneve të sigurisë në KSK. Nga ana tjetër, Kuvendi nuk ka mundur të garantojë që opinioni i AP të jetë gjithnjë i përfshirë në projekt-ligjet propozuar nga qeveria për institucionet e sigurisë.

Megjithatë, një hap pozitiv mund të thuhet se është ndërmarrë me krijimin e Shërbimit për Monitorimin e Marrëdhënieve të Institucioneve të Pavarura me Kuvendin i cili ka rritur numrin e komunikimeve me AP.<sup>36</sup>

Që prej themelimit të institucionit në vitin 2000, AP është bërë një pikë e rëndësishme referimi për qytetarët. Numri i lartë i ankimeve dhe i çështjeve të zgjidhura justifikojnë rritjen e nivelit të besueshmërisë publike kundrejt këtij institucioni. AP mirëmban një faqe interneti e cila është lehtësisht e aksesueshme dhe ofron informacion të pasur. Përveç fushatave informuese për të vendosur kontaktet me publikun, AP ka përfituar gjerësisht nga mediat për të komunikuar si edhe për të paraqitur pikëpamjet dhe shqetësimet e këtij institucioni.<sup>37</sup>

## **2.2. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

Ky seksion analizon institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDhP). Së pari analizohet themelimi i institucionit dhe trashëgimia nga AP. Më pas analizohet misioni, juridiksioni dhe niveli i pavarësisë së KMDhP si edhe së fundmi zbatimi i legjislacionit dhe performanca e institucionit të KMDhP. Analiza bazohet në legjislacionin përkatës, raportet e KMDhP në Kuvend si edhe në burime të tjera dytësorë.

### 2.2.1 Themelimi dhe trashëgimia nga AP

Kushtetuta përcakton dispozita të qarta për të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, përveçse kur kjo rregullohet me ligj dhe për të drejtën për të ndrequr ose fshirë të dhënat e pavërteta ose të paplota të mbledhura në kundërshtim me ligjin.<sup>38</sup> Në përputhje me Kushtetutën, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale u miratua nga Kuvendi dhe Avokatit të Popullit ju dha kompetenca për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit dhe për të krijuar regjistrin e mbrojtjes së të dhënave.<sup>39</sup> Megjithatë, performanca e AP në këtë

<sup>36</sup> Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 29, datë 9.7.2007, “Për themelimin e shërbimit për monitorimin e institucioneve që raportojnë dhe informojnë parlamentin”.

<sup>37</sup> Raporti i AP në Kuvend për vitin 2009 nxjerr në pah rreth 370 artikuj gazetash dhe transmetimesh televizive të lidhura me aktivitetin e institucionit.

<sup>38</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 35

<sup>39</sup> Ligj Nr. 8517, datë 22,7,1999 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Neni 15

drejtim, rezultoi e dobët duke qenë se legjislacionit i mungonin dispozitat specifike për zbatimin e tij.<sup>40</sup>

Në vitin 2004, Kuvendi ratifikoi Konventën për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale dhe Ligjin për Ratifikimin e Protokollit Shtesë për Konventën për Mbrojtjen e Individëve (PShKMI) për Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale për autoritetet mbikëqyrëse dhe për shkëmbimin ndër-kufitar të të dhënave. PShKMI thekson krijimin e një strukture të pavarur mbikëqyrëse me “kompetenca për hetim dhe ndërhyrje, si edhe për t’u përfshirë në akte ligjorë ose për të sjellë në vëmendje të autoriteteve gjyqësorë përkatës raste të shkeljes së legjislacionit të brendshëm.”<sup>41</sup> Pas ratifikimit të PShKMI, Shqipëria ka shprehur vullnetin për themelimin e një autoriteti të pavarur për mbrojtjen e të dhënave personale edhe ndaj Bashkimit Evropian (BE) në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.<sup>42</sup> Ligji i ri për mbrojtjen e të dhënave personale që themeloi Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDhP) u miratua në vitin 2008.

### *2.2.1.1. Mbrojtja e të dhënave Personale përpara vitit 2008*

Edhe pse ligji për mbrojtjen e të dhënave personale ishte miratuar që në vitin 1999, raportet e Avokatit të Popullit në Kuvend kanë filluar ta përmendin mbrojtjen e të dhënave vetëm që prej vitit 2005,<sup>43</sup> me krijimin për herë të parë të regjistrit të të dhënave personale.<sup>44</sup> Megjithatë ky regjistër nuk u përdor ndonjëherë.<sup>45</sup> Në vitet në vazhdim, deri në vitin 2008, AP është marrë me disa raste të izoluar të cilët shkelnin ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë kryesisht ankesat për akte nënligjore të lëshuara nga autoritetet policore.<sup>46</sup> AP kishte arritur në konkluzionin se numri i ulët i rasteve të raportuara prej qytetarëve lidhur me këtë të drejtë kryesore vinte si pasojë e mungesës së informimit të publikut mbi këtë të drejtë thelbësore dhe se kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur shkelje të saj.<sup>47</sup> Megjithë performancën e dobët në mbikëqyrjen e drejtpërdrejte të zbatimit të këtij ligji, AP ka qenë një mbështetës i fortë për themelimin e KMDhP dhe ka kontribuar në shumë mënyra për këtë institucion.<sup>48</sup>

### *2.2.2 Mandati, kompetencat dhe juridiksioni*

<sup>40</sup> Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2008”

<sup>41</sup> Këshilli i Evropës, “Protokolli Shtesë për Konventën Për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Procedimin Automatik të të Dhënave Personale për autoritet mbikëqyrëse dhe shkëmbimit të të dhënave ndër-kufitare”, Nëntor 2001; Strasburg, fq. 8. <http://www.garanteprivacy.it/garante/document?ID=1798198>. Parë në tetor 2011

<sup>42</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian, “Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe vendeve të tyre anëtarë dhe Republikës së Shqipërisë”, 22 maj 2006; Bruksel [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf). Parë në tetor 2011

<sup>43</sup> Referencë e kësaj gjendet në raportin e vitit 2004 i cili përmend rrezikun për abuzimin me të dhënat personale nga media.

<sup>44</sup> Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2005”, 26

<sup>45</sup> Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2008”

Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2006”

<sup>47</sup> Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2007”

<sup>48</sup> Avokati i Popullit, “Rekomandime të Avokatit të Popullit për Kryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë të datës 3 maj 2007 mbi përgatitjen e projekt-ligjit për themelimin e një autoriteti mbikëqyrës të pa varur përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri”,

<http://www.avokatipopullit.gov.al/Korrespondenca/Korr%2022052009.htm>, Parë në gusht 2011

KMDhP është autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron, nw përputhje me ligjin mbrojtjen e të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat themelore të njeriut.<sup>49</sup> Kompetencat e KMDhP përfshijnë kryerjen e hetimeve administrative, autoritetin për të urdhëruar bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullimin e përpunimit të paligjshëm të të dhënave, dhe dhënien e udhëzimeve përpara përpunimit të tyre.<sup>50</sup> KMDhP autorizon gjithashtu transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.<sup>51</sup>

Të gjithë institucionet shtetërorë dhe privatë janë të detyruar të bashkëpunojnë me KMDhP duke i ofruar informacionin e nevojshëm për përmbushjen e kompetencave të tij.<sup>52</sup> Megjithatë, përsa i përket institucioneve të sektorit të sigurisë, KMDhP ka juridiksion të kufizuar. Ligjit i mungojnë detajet për akses tek informacioni i klasifikuar. Një akses i tillë mund të kufizohet për arsye të sigurisë kombëtare, për politikat e jashtme ose për interesa të tjera të rëndësishëm të shtetit.<sup>53</sup> Përveç kësaj, ligji përjashton institucionet e sigurisë kombëtare dhe institucionet për parandalimin e krimit nga detyrimi për të informuar KMDhP mbi përpunimin e të dhënave.<sup>54</sup>

### 2.2.3 Pavarësia dhe Burimet

Titullari i institucionit të KMDhP zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave, ka një mandat pesë vjeçar dhe ka të drejtë të ri-zgjidhet. Kuvendi miraton buxhetin dhe strukturën administrative të institucionit. Megjithatë, aktet nën-ligjorë që rregullojnë zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave hartohen nga Këshilli i Ministrave, duke kufizuar kështu pavarësinë e KMDhP.

KMDhP raporton për aktivitetin e tij vjetor një herë në vit përpara Kuvendit por mund të thirret të raportojë edhe kur Kuvendi e gjykon të arsyeshme.<sup>55</sup>

### 2.2.4 Zbatimi i legjislacionit dhe performanca

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zgjodh nga Kuvendi disa muaj pas miratimit të ligjit.<sup>56</sup> Pak pas kësaj, institucioni u pajis me zyrat dhe stafin përkatës. Aktualisht, KMDhP ka një staf prej 29 personash, por sipas përfaqësuesve të tij ky staf nuk është tërësisht i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e institucionit. Hapësirat e zyrave konsiderohen si të mjaftueshme por pajisjet e tyre nuk mjaftojnë për të gjithë stafin. Përveç financimeve nga buxheti i shtetit, KMDhP ka marrë financime dhe donacione edhe nga Komisioni i BE, Këshilli i Evropës dhe OSBE.<sup>57</sup> Megjithatë, buxheti mjafton për pagesat e rrogave të stafit dhe për veprimet bazë por, duke pasur parasysh qëllimin e institucionit, fondet nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur të gjithë aktivitetet e tij. Trajnimi dhe kualifikimi i stafit përbën një prioritet kryesor për këtë institucion i cili është adresuar me anë të seminareve dhe trajnimeve brenda dhe jashtë vendit.

<sup>49</sup> Ligj Nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Neni 29

<sup>50</sup> Ligj Nr. 9887, Neni 30

<sup>51</sup> Ligj Nr. 9887, Nenet 8,9

<sup>52</sup> Ligj Nr. 9887, Neni 32

<sup>53</sup> Ligj Nr. 9887, Neni 12

<sup>54</sup> Ligj Nr. 9887, Neni 21

<sup>55</sup> Ligj Nr. 9887, Neni 31

<sup>56</sup> Komisionerja Flora Çabej u zgjodh në shtator të vitit 2008.

<sup>57</sup> Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Raporti vjetor në Parlament për vitin, 2010”

Komisioneri lëshon urdhra administrative dhe rregullore dhe Këshilli i Ministrave ka aprovuar aktet nënligjorë për zbatimin e ligjit.<sup>58</sup>

Siç parashikohet dhe në dispozitat ligjore përkatëse, ndërveprimi i KMDhP me sektorin e sigurisë është i kufizuar. Kjo reflektohet gjithashtu në raportet që i paraqiten Kuvendit. Megjithatë duke pasur parasysh vështirësinë për pasjen e një përkufizimi specifik të termit siguri kombëtare, mbetet e paqartë se si përcaktohen në këtë rast të dhënat që lidhen me sigurinë kombëtare. Për shkak të ndërveprimit të kufizuar të KMDhP me institucionet e sektorit të sigurisë kjo çështje ende nuk ka dalë në pah tërësisht.

Disa ndërveprime të hershme të KMDhP me sektorin e sigurisë janë shënuar nëpërmjet bashkëpunimit me Policinë e Shtetit (PSh). Më konkretisht, institucioni i KMDhP ka firmosur marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ka hartuar ligje dhe rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale nga PSh.<sup>59</sup> Një qasje tjetër ka qenë informacioni mbi strukturat e policisë në seminare të përbashkëta të organizuar nga KMDhP me PSh për të diskutuar legjislacionin dhe praktikën më të mira për mbrojtjen e të dhënave personale nga PSh.<sup>60</sup>

### **2.3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**

Ky seksion do të analizojë institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) duke parë themelimin dhe kuadrin ligjor të këtij institucioni, kapacitetet e tij, performancën, kontributin kryesor dhe sfidat me të cilat përballet.

#### 2.3.1 Themelimi dhe kuadri ligjor

Kushtetuta e Shqipërisë thekson se “të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të gjinisë, racës, gjuhës, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore.”<sup>61</sup> Bazuar mbi këto principe dhe me nxitjen e komunitetit ndërkombëtar dhe shoqërisë civile, Shqipëria miratoi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) në shkurt të vitit 2010.<sup>62</sup> Ligji synon të rregullojë zbatimin dhe implementimin e principit të trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit mbi bazën e një liste të gjerë shkaqesh ku përfshihen gjinia, raca, aftësitë dhe orientimi seksual.

Pra LMD ka për qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për të pasur një mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin si edhe të mundësojë barazinë e shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, gëzuar liritë dhe

---

<sup>58</sup> Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Raporti vjetor në Parlament për vitin, 2009” dhe, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Raporti vjetor në Parlament për vitin, 2011”

<sup>59</sup> Informacion i shkruar nga KMDhP

<sup>60</sup> Seminar për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e policisë, 7 tetor 2011, <http://ëëë.kmdp.al/>, Parë në tetor 2011

<sup>61</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 18.

<sup>62</sup> Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “Raport analitik që shoqëron Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Opinion i Komisionit për Aplikimin për Anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë”, 9 nëntor 2010, Bruksel

[http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargment/47f\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargment/47f_en.htm), Parë në shtator 2011.



për pjesëmarrje në jetën publike.<sup>63</sup> Principet e mundësuar nga LMD janë të vlefshëm për të gjithë sektorët publikë duke përfshirë dhe institucionet e sektorit të sigurisë.

Në përputhje me LMD, titullari i institucionit të KMD u emërua në prill të vitit 2010 për t'u marrë me çështjet e diskriminimit dhe me politikat që mbuloleshin më parë prej Avokatit të Popullit. Megjithatë, në ndryshim nga Avokati i Popullit, fusha ku vepron KMD është më e zgjeruar pasi përfshin jo vetëm institucionet publikë por edhe ato privatë.<sup>64</sup> KMD përfaqëson mekanizmin e vendosur për të garantuar mbrojtjen efikase nga diskriminimi dhe pabarazitë për individët dhe subjektet ligjorë. Në këtë kuadër, detyrat e Komisionerit përfshijnë autoritetin:

- për të shqyrtuar ankesat nga personat ose nga grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar
- të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi,
- Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të LMD-së
- të vendosë sanksione administrative për ata që shkelin këtë ligj
- si edhe të bëjë rekomandime për përmirësimin ose nxjerrjen e legjislacionit përkatës mbi diskriminimin<sup>65</sup>

KMD zgjidhet me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të Kuvendit me propozim të një grupi deputetësh. Komisioneri ka mandat pesë vjeçar me të drejtë ri-zgjedhjeje vetëm një herë.<sup>66</sup>

Komisioneri raporton në Kuvend mbi zbatimin e LMD dhe për aktivitetet e tij të paktën një herë në vit. Për shkak se është themeluar vetëm së fundmi, KMD ka raportuar vetëm një herë përpara KÇLAPDNj. Raporti thekson se numri i ankesave ka qenë katër dhe një prej tyre është dorëzuar nga një ish-funksionar i Policisë së Shtetit.<sup>67</sup> Në këtë drejtim, Policia e Shtetit ka qenë tërësisht bashkëpunuese me Komisionerin për të rishikuar këtë ankesë.<sup>68</sup>

### 2.3.2 Kapacitetet

Institucioni i KMD ka buxhetin e tij i cili financohet nga buxheti i shtetit dhe nga një sërë donacionesh.<sup>69</sup> Tkurrja e buxhetit për vitin 2010, ka ndikuar procesin e rekrutimit të stafin në lidhje me numrin e personelit të rekrutuar. KMD ka një staf prej 20 vetësh në vend të 23 që përcaktohen në vendimin përkatës të Kuvendit.<sup>70</sup> Gjithashtu raporti analitik i

<sup>63</sup> Ligj Nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Neni 2.

<sup>64</sup> Sipas komenteve që u bënë nga përfaqësuesja e këtij institucioni në konferencën përfundimtare për prezantimin e këtij studimi.

<sup>65</sup> Ligj Nr. 10221, Neni 32.

<sup>66</sup> Ligj Nr. 10221, Neni 25.

<sup>67</sup> Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Raport vjetor në Kuvend, 2010"

<sup>68</sup> Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Letër zyrtare nga KMD për IDM", datë 13. 10. 2011.

<sup>69</sup> Ligj Nr. 10221, Neni 21.

<sup>70</sup> Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 34, datë 20.5.2010, "Mbi aprovimin e strukturës organizative dhe klasifikimit të pagave për punonjësit e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi"

Komisionit Evropian thekson se Zyra e Komisionerit nuk është tërësisht operacionale. Prandaj, një financim i duhur për zyrën në fjalë është i domosdoshëm për të siguruar kapacitetin e saj për të ekzaminuar ankesat dhe për të ndërmarrë aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit në zbatimin e principit të trajtimit të barabartë.<sup>71</sup>

### 2.3.3. Performanca

Duke pasur parasysh se KMD është themeluar vetëm përpara pak kohësh, është e vështirë të vlerësohet performanca dhe kontributi i këtij institucioni për mbrojtjen nga diskriminimi. Pavarësisht nga ky fakt, buxheti i kufizuar ka rezultuar në nivele të ulëta ndërgjegjësimit për LMD dhe KMD si mekanizmi kryesor që garanton zbatimin e dispozitave të ligjit në fjalë.<sup>72</sup> Kjo gjithashtu ka penguar përmbushjen e kompetencave të komisionerit dhe të funksioneve të tij sipas ligjit.<sup>73</sup>

### 2.3.4. Kontributet dhe sfidat

LMD thekson se Këshilli i Ministrave, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministri i Brendshëm janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me fushat përkatëse të aktivitetit të tyre.<sup>74</sup> Në përputhje me LMD, Kryeministri ka nxjerrë një Urdhër për të rregulluar më tej zbatimin e ligjit në ministrinë përkatëse.<sup>75</sup> Megjithatë, lidhur me sektorin e sigurisë, në të ardhmen e afërt nuk do të ketë ndonjë përqendrim të veçantë për rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtën për mbrojtjen nga diskriminimi në institucionet e sektorit të sigurisë.

Prandaj, prioritetet kryesore të zyrës së KMD do të jenë fushatat për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi, forcimi i bashkëpunimit me aktorët e tjerë të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qofshin këta institucione publike, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile, ndërtim kapacitetesh për personelin dhe bërja e rekomandimeve për përmirësimin e legjislativitetit aktual.<sup>7677</sup>

---

<sup>71</sup> Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “Raport analitik që shoqëron Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Opinion i Komisionit për Aplikimin për Anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë” 9 nëntor 2010, Bruksel [http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargement/47f\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargement/47f_en.htm), Parë në shtator 2011.

<sup>72</sup> Fondacioni për një Shoqëri të Hapur në Shqipëri, “Analiza dhe Rekomandime për Planveprimin për Adresimin e 12 rekomandimeve të opinionit të KE-së”, 22 prill 2011. [http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/OSFA%20-%20Analysis%20of%20Action%20Plan%20-%202012%20EC%20Recommendations%20-%20april%202011\\_EN.pdf](http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/OSFA%20-%20Analysis%20of%20Action%20Plan%20-%202012%20EC%20Recommendations%20-%20april%202011_EN.pdf). Parë në shtator 2011.

<sup>73</sup> Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Letër zyrtare nga KMD për IDM, datë 13. 10. 2011.

<sup>74</sup> Ligj Nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Neni 14

<sup>75</sup> Urdhër Nr. 57, datë 29.4.2011, “Mbi firmosjen e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre të cilat kanë detyrimin për të marrë masa në kuadër të luftës kundër diskriminimit dhe Komisionerit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit”

<sup>76</sup> Diskutim në Fokus Grup me Përfaqësues të IPM, 13 tetor 2011.

<sup>77</sup> Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Raport vjetor në Kuvend, 2010”

### **3. Kontrolli i Buxhetit të Shtetit, prokurimeve dhe Korrupsionit**

Ky seksion analizon IPM mandati i të cilave lidhet me aktivitetin financiar të institucioneve të sektorit të sigurisë. Institucioni i parë që do të analizohet është Kontrolli i Lartë i Shtetit i ndjekur nga Avokati i Prokurimeve dhe nga Inspektoriati i Lartë për Deklarimin e Pasurive .

#### **3.1. Kontrolli i Lartë i Shtetit**

Kjo pjesë analizon institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH). Analiza përqendrohet në trashëgiminë e KLSH dhe në transformimin e tij në një institucion i cili përmbush standardet dhe normat ndërkombëtare të auditimit. Më pas analizohet mandati, juridiksioni dhe pavarësia e KLSH bazuar në dispozitat ligjore dhe ato kushtetuese dhe në mbyllje analizohet zbatimi i legjislacionit dhe performanca e KLSH-së.

##### 3.1.1. Themelimi

KLSH u themelua së pari në vitin 1992, si një institucion zyrtarisht i pavarur nga ekzekutivi.<sup>78</sup> Megjithatë, legjislacioni dhe praktika nuk ishin në përputhje me standardet ndërkombëtare të një institucioni të auditit të jashtëm, si për sa i përket qëllimit të mandatit ashtu edhe lidhur me pavarësinë e institucionit. Përveç kontrollit të buxhetit të shtetit, KLSH u përfshi në kryerjen e kontrolleve financiarë të brendshëm. Lidhur me pavarësinë, gjatë kësaj periudhe KLSH ka qenë e lidhur ngushtë me Qeverinë dhe kryetari i KLSH vazhdonte të ishte anëtar aktiv i partisë politike në pushtet.<sup>79</sup>

Me miratimin e ligjit të ri në vitin 1997 dhe të Kushtetutës në vitin 1998, KLSH filloi transformimin për të vendosur institucionin në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Kështu, në ndryshim nga IPM e tjerë të cilët u përballën fillimisht me sfidat e ndërtimit institucional, sfida kryesore e KLSH ishte të transformonte kulturën institucionale dhe modernizonte kapacitetet ekzistues.

Asistenca dhe mbështetja ndërkombëtare ka pasur një rëndësi kryesore në këtë proces. Projekti i Mbështetjes për Përmirësimin në Qeverisje dhe Menaxhim (PPQM) dhe ndihmat dy paleshe, si projekti i binjakëzimit me Zyrën Kombëtare të Auditit në Britaninë e Madhe dhe Gjykatën e Auditit të Holandës, kanë ndihmuar KLSH që të përmirësojë kapacitetet administrativë dhe performancën, si dhe për hartimin e një Plani të Ri Strategjik të Zhvillimit për periudhën 2009-2012.

Me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, KLSH përfaqësohet rregullisht në Bordin Ndërkombëtar të Auditorëve të NATO, i cili që në vitin 2006 aplikon Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik, për auditimin e shpenzimeve të buxhetit të

---

<sup>78</sup> Megjithëse ky institucion ka ekzistuar në forma të ndryshme edhe gjatë Regjimit Komunist dhe Monarkisë, ky studim fokusohet në mbikëqyrjen e institucioneve demokratike mbi sektorin e sigurisë dhe për këtë arsye analiza e KLSH fillon me miratimin e ligjit të parë nga Kuvendi i parë pluralist në vitin 1992.

<sup>79</sup> Faqja zyrtare e internetit e KLSH, <http://www.klsh.org.al/mat.php?idm=80&l=a>, Parë në shtator 2011

NATO.<sup>80</sup> Këto shkëmbime do të përbëjnë një tjetër mundësi që KLSH të përmirësojë më tej standardet e performancës.

### 3.1.2. Kuadri Kushtetues dhe Ligjor

#### *3.1.2.1 Mandati*

Kushtetuta themelon KLSH si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar mbi institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor.<sup>81</sup> KLSH ka autoritetin për të ndërmarrë auditimin e të gjithë institucioneve shtetërore që financohen tërësisht ose pjesërisht nga buxheti i shtetit, duke përfshirë auditin financiar, auditin e performancës dhe audite të tjerë specifike për ligjshmërinë, për ekzekutimin e urdhrave, për menaxhimin financiar dhe auditin për aspekte të performancës.<sup>82</sup>

Objektivat kryesorë të KLSH janë kontrolli i përdorimit të duhur dhe me efikasitet të fondeve publikë, zhvillimi i miradministrimit financiar të qëndrueshëm dhe kontrolli i zbatimit të ligjeve në fushën ekonomike dhe financiare.<sup>83</sup>

#### *3.1.2.2. Pavarësia*

Kushtetuta dhe ligji për KLSH përmbajnë dispozitat që garantojnë pavarësinë e këtij institucioni në aspektet e funksionimi të tij, veprimtarisë dhe nga ana administrative. Kryetari i KLSH zgjidhet dhe shkarkohet nga funksioni me anë të një procedure të veçantë. Kryetari i KLSH zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës për një mandat shtatë vjeçar dhe të rinovueshëm. Ligji specifikon rastet kur mandati i Kryetarit të KLSH mund të ndërpritet.<sup>84</sup> Kryetari i KLSH gëzon imunitet nga hetimi njësoj si një anëtar i Gjykatës së Lartë. Konfliktet mbi kompetencat e KLSH dhe ato të institucioneve të tjerë shtetërore mund ti referohen për zgjidhje Gjykatës së Apelit.<sup>85</sup>

Për të forcuar më tej pavarësinë e këtij institucioni ligji thekson se KLSH është një institucion i de-politizuar. Kryetarit dhe punonjësve të tij iu ndalohej pjesëmarrja në aktivitete politike.<sup>86</sup>

KLSH ka buxhetin e tij të pavarur i cili mundësohet nga Buxheti i Shtetit dhe miratohet nga Kuvendi. Kryetari i KLSH gëzon pavarësi gjatë menaxhimit të burimeve financiare dhe njerëzore dhe planifikimit të aktiviteteve të këtij institucioni.

---

<sup>80</sup> Bordi Ndërkombëtar i Auditorëve për NATO-n [http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_55937.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_55937.htm), Parë në shtator 2011.

<sup>81</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 162

<sup>82</sup> Ligj Nr. 8270, datë 23.12.1997, ndryshuar me Ligj Nr. 8599, datë 01.6.2000, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”

<sup>83</sup> Ligj për KLSH, Neni 6

<sup>84</sup> Mandati i Kryetarit të KLSH përfundon vetëm nëse ai jep dorëheqjen, nëse është i dënua për çështje kriminale me anë të një vendimi final të gjykatave, nëse ai mungon nga detyra për më shumë se 6 muaj, nëse deklarohet i pa aftë fizikisht ose mendërisht për kryerjen e funksioneve të tij dhe nëse ai ngarkohet me një detyrë tjetër e cila është e pa përputhshme me këtë funksion.

<sup>85</sup> Ligji për KLSH, Neni 5

<sup>86</sup> Ligji për KLSH, Nenet 12 dhe 20

KLSH raporton në Kuvend dhe prezanton atje një raport vjetor mbi aktivitetin e institucionit.<sup>87</sup>

Megjithatë, ligji ka nevojë për rregullime të mëtejshme për të qenë tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtarë në disa aspekte teknike që përfshijnë edhe kriterin për uljen e numrit të kushteve për dorëheqjen nga detyra të Kryetarit të KLSH.<sup>88</sup>

### 3.1.2.3 Juridiksioni mbi institucionet e sektorit të sigurisë

Asnjë institucion nuk përjashtohet nga juridiksioni i KLSH. Ai ka autoritetin për të kontrolluar aktivitetin financiar të të gjithë institucioneve shtetërorë duke përfshirë edhe institucionet e sektorit të sigurisë. KLSH ka të drejtën të pajiset me të gjithë informacionin që gjykon të nevojshëm për kryerjen e funksioneve të tij.<sup>89</sup> Përveç kësaj, ai ka autoritetin të adresojë pyetje kundrejt punëdhënësve dhe të ketë akses në mjediset përkatëse gjatë kryerjes së aktiviteteve auditues. Për të mbrojtur informacionin e klasifikuar, ligji mundëson që aktivitetet financiarë që klasifikohen si sekret shtetëror të kontrollohen vetëm prej stafit të autorizuar nga Kryetari i KLSH i cili raporton gjetjet tek Komisioni i Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.<sup>90</sup>

### 3.1.2.4 Zbatimi i legjislacionit

Që prej vitit 1998, KLSH është konsoliduar gjithnjë e më shumë përgjatë katërmbëdhjetë viteve të fundit. Mandati i Kryetarit të parë u përfundua normalisht. Zgjedhjet për Kryetarin e dytë kaluan nëpër një proces të rregullt dhe pa probleme dhe kandidati u mbështet si nga mazhoranca ashtu edhe nga opozita gjatë votimit në Kuvend.<sup>91</sup>

Që prej vitit 2008 pavarësia e KLSH është rritur ndërsa procedura për propozimin e buxhetit të këtij institucioni ka përjashtuar qeverinë. Projekt-buxheti propozohet nga KLSH në Komisionin për Ekonominë dhe Financën (KEF) i cili e prezanton atë për miratim në Kuvend.

Numri total i stafit të KLSH është 160 nga të cilët 118 janë auditues. Përsa i përket cilësisë së stafit, institucioni nuk ka probleme në rekrutimin e njerëzve të kualifikuar ndërsa hapësirat e zyrave konsiderohen si të pamjaftueshme.<sup>92</sup> KLSH thekson plotësimin e numrit të nevojshëm të stafit si një nga objektivat e tij kryesor krahas përmirësimit të burimeve njerëzore dhe të sistemeve të menaxhimit.<sup>93</sup>

KLSH ka raportuar rregullisht në Kuvend mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit dhe aktivitetet e tij. Raporti përfshin referenca mbi parregullsitë financiare dhe ato procedurale

<sup>87</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 164

<sup>88</sup> SIGMA "Vlerësim i Auditit të jashtëm në Shqipëri" Maj 2009. <http://www.oecd.org/dataoecd/0/56/43910245.pdf>. Parë në shtator 2011

<sup>89</sup> Ligji për KLSH, Neni 17

<sup>90</sup> Ligji për KLSH, Nenet 21, 22

<sup>91</sup> Duhet theksuar se mandati i Kryetarit Aktual të KLSH përfundon në 28 tetor 2011, kështu që do të jetë interesant të shikohet nëse zgjedhja e kryetarit të ardhshëm do të kryhet në të njëjtën mënyrë.

<sup>92</sup> SIGMA, "Vlerësim i Auditit të jashtëm në Shqipëri" maj 2009.


<sup>93</sup> Kontrolli i Lartë i Shtetit, "Plani i Zhvillimit Strategjik të KLSH 2009-2012", <http://www.klsh.org.al/doc/20091224103949PlaniStrategjikiZhvill.2009-2012.pdf>. Parë në tetor 2011

që kanë dalë gjatë kontrollit të institucioneve të sektorit të sigurisë si dhe rekomandimet që janë lëshuar nga KLSH për rastet në fjalë. Nga analizimi i raporteve dhe nga informacioni i marrë nga KLSH nuk janë evidentuar probleme përsa i përket kontrollit të institucioneve të sigurisë. Për të pasur akses tek dokumentet e klasifikuara, Kryetari i KLSH dhe audituesit të cilët kanë akses në institucionet e sektorit të sigurisë kontrollohen dhe pajisen me Karta për Personelin e Sigurisë.<sup>94</sup>

### 3.1.3 Performanca e KLSH

Siç u pa edhe më sipër, sfida e kryesore e KLSH ka qenë transformimi dhe modernizimi i institucionit si edhe sigurimi i pavarësisë së tij. Çdo vit, kryetari i KLSH prezanton dy raporte në Kuvend, një mbi aktivitetet në pranverë dhe një tjetër për shpenzimin e buxhetit në vjeshtë. Format i raportimit dhe informacioni i përfshirë në raporte janë përmirësuar, në mënyrë të veçantë që prej vitit 2008.

Raportet përmbajnë informacion mbi parregullsitë e evidentuara gjatë kontrollit të institucioneve të sigurisë dhe mbi sanksionet ose rekomandimet përkatëse që janë propozuar për secilin rast. Niveli i pranueshmërisë për rekomandimet e lëshuara nga KLSH është rritur (Grafiku 3). Nuk ka qenë e mundur marrja e të dhënave mbi zbatimin e rekomandimeve nga institucionet e sektorit të sigurisë, por duke qenë se raportet nuk përmbajnë raste ankimore specifike për këto institucione, niveli duhet të jetë nën marzhet e treguara në grafikun e mëposhtëm.



Grafiku 3: Niveli i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH gjatë periudhës 2005-2010  
Burimi: Të dhëna të mbledhura nga raportet e KLSH në Kuvend.

Përveç aktivitetit auditues KLSH vlerëson rregullisht edhe performancën e auditit të brendshëm në institucionet e sektorit të sigurisë.

<sup>94</sup> Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Informacionit të Klasifikuar.

Një fushë e cila nuk përfshihet në raporte është kontrolli i fondeve të përdorura për qëllime të sigurisë kombëtare shpenzimet e të cilave nuk bëhen publike. Bazuar mbi informacionin e marrë nga KLSH për këtë studim, ky institucion ka ndërmarrë kontrolle periodikë mbi shpenzimet e buxhetit të klasifikuar në të gjithë institucionet e sektorit të sigurisë sipas termave afatmesëm dhe sipas kalendarit vjetor të auditit.<sup>95</sup> Megjithatë, analiza e raporteve të prezantuara në Kuvend nuk tregon evidencë që KLSH të ketë kontroll mbi këtë pjesë të buxhetit. Të njëjtat gjetje dalin nga analizimi i shënimeve të mbajtura gjatë sesionit të pyetjeve të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nga anëtarët e KSK pas raportimit.

Raporti më i fundit tregon progres në lidhje me raportimin e këtyre kontrolleve. Gjatë vitit 2009 raporti i KLSH theksoi se Ministria e Mbrojtjes (MM), Ministria e Brendshme (MB) dhe Shërbimi Informativ Shtetëror (ShiSh) kanë harxhuar një sasi të konsiderueshme fondesh për kontraktime që lidhen me ‘interesa të lartë shtetërore’.<sup>96</sup> KLSH ka identifikuar se fonde të tilla janë përdorur në mungesë të plotë të akteve nënligjore për të përcaktuar procedurat që duhen ndjekur prej këtyre institucioneve dhe ka paralajmëruar mbi rrezikun për një keqpërdorim potencial të këtyre fondeve. Kjo ka shkaktuar reagimin e Këshillit të Ministrave i cili në vijim ka nxjerrë një akt për të rregulluar prokurimin që kryhet sipas dispozitave të klasifikuara.<sup>97</sup> Megjithatë, raporti i fundit i aktivitetit të KLSH për vitin 2010 nuk përmban evidencë nëse situata është përmirësuar ose jo pas miratimit të këtij akti.<sup>98</sup>

## **3.2. Avokati i Prokurimeve**

Kjo pjesë analizon institucionin e Avokatit të Prokurimeve (AvP). Fillimisht analiza përqëndrihet në kuadrin ligjor dhe krijimin e institucionit të AvP në vitin 2006. Më tej analizohen funksioni, kapacitetet institucionale dhe performanca a AvP.

### 3.2.1. Themelimi dhe kuadri ligjor

Avokati i Prokurimeve u themelua si institucion i pavarur nga Ligji për Prokurimin Publik (LPP),<sup>99</sup> i ndryshuar.<sup>100</sup> AvP zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave dhe ka një mandat pesë vjeçar të rinovueshëm.<sup>101</sup>

Qëllimi i veprimtarisë së AvP është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të ofertuesve, dhe ofruesve që marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik, koncesionit<sup>102</sup>

---

<sup>95</sup> Informacioni i shkruar dhënë nga KLSH

<sup>96</sup> Kontrolli i Lartë i Shtetit, “Raport mbi aktivitetin e KLSH në Kuvend për vitin 2009”, fq. 37

<sup>97</sup> Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 121, datë 02.02.2009, “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar si ‘sekret shtetëror’ në fushën industriale”

<sup>98</sup> Kontrolli i Lartë i Shtetit, “Raport vjetor mbi aktivitetin e KLSH në Kuvend për vitin 2010”

<sup>99</sup> Ligj Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin Publik”, Neni 14.

<sup>100</sup> Ligj Nr. 9800, datë 10.9.2007, Ligj Nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligj Nr. 10170, datë 22.10.2009, dhe Ligj Nr. 10309, datë 22.07.2010

<sup>101</sup> Ligj Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin Publik”, Neni 15.

<sup>102</sup> Ligj Nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, i ndryshuar, Neni 7.

dhe ankandit publik<sup>103</sup> nga veprimet e paligjshme apo mosveprimet nga ana e autoriteteve kontraktorë. Në përmbushje të këtyre funksioneve, AvP monitoron dhe heton performancën dhe përmbushjen e procedurave administrative sipas ligjeve dhe akteve normative në fuqi.

Monitorimi dhe hetimi i procedurave të prokurimit publik që ndërmerret nga AvP është gjithashtu i vlefshëm edhe për institucionet e sektorit të sigurisë. Megjithatë, bazuar në dispozitat ligjore për prokurimin publik, AvP nuk ka kompetenca për monitorimin ose hetimin e procedurave të prokurimit në rastet kur kërcënohet siguria kombëtare ose interesat themelore të shtetit.<sup>104</sup> Këto dispozita ligjore janë adresuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për zbatimin e prokurimit të të mirave, punës dhe shërbimeve të tjera që lidhen me sigurinë e informacionit të klasifikuar si “Sekret Shtetëror” në fushën industriale.<sup>105</sup> Në bazë të këtij vendimi Drejtoria për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar (DSIK) është përgjegjëse për kontrollin e procedurave të prokurimit sipas ligjeve dhe vendimeve në fuqi.

Duke pasur parasysh veçantitë dhe specifikat që paraqet sektori i sigurisë, eksperiencia e vendeve të Evropës Perëndimore tregon se niveli i tepruar i fshehtësisë që karakterizon blerjen e pajisjeve të veçanta në fushën e mbrojtjes mund të shërbejë për të mbuluar kontrollin e dobët financiar, shpenzimet e pa nevojshme dhe korrupsionin.<sup>106</sup>

AvP mund të nxjerrë rekomandime për Autoritetet Kontraktore (AK) dhe të propozojë ndryshime, përditësime dhe përmirësime të ligjeve. Që nga viti 2007, AvP ka raportuar çdo vit në Kuvend. Përveç raportimit vjetor, AvP ka raportuar çdo tre muaj në Drejtorinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, qëkurse ky institucion u krijua pranë Kuvendit. Në raportin e tij për Kuvendin për vitin 2010 AvP deklaroi se shumica e rekomandimeve që i janë adresuar AK janë marrë në konsideratë prej tyre.<sup>107</sup>

Ndryshe nga viti paraardhës, në raportin e vitit 2010 AvP nuk raportoi për ndonjë problematike lidhur me institucionet e sektorit të sigurisë gjatë shqyrtimit të ankesave dhe monitorimit të procedurave të prokurimit publik që kryhen nga AK.<sup>108</sup> Raporti nuk adresoi ndonjë çështje ose shqetësim përse i përket prokurimeve publike të ndërmarra nga institucionet e sektorit të sigurisë, dhe nuk përmban të dhëna për këto çështje. Në raportet e viteve 2008<sup>109</sup> dhe 2009<sup>110</sup> AvP ka evidentuar disa çështje të prokurimit publik në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, ShiSh dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të cilat lidhen me efikasitetin e platformës së prokurimit elektronik, mungesën e bashkëpunimit me AvP gjatë shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, vonesat në kryerjen e procedurave të prokurimit, mungesën e përputhshmërisë me kuadrin ligjor gjatë hartimit të

<sup>103</sup> Ligj Nr. 9874 datë 14.02.2008, “Për ankandin publik”

<sup>104</sup> Ligj Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, Neni 5 dhe 6.

<sup>105</sup> Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 121, datë 02.02.2009, “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar si ‘sekret shtetëror’ në fushën industriale”

<sup>106</sup> DIFID, “*Understanding and Supporting Security Sector Reform*”, fq. 33.

<sup>107</sup> [http://www.ssnetwork.net/uploaded\\_files/4033.pdf](http://www.ssnetwork.net/uploaded_files/4033.pdf). Parë në tetor 2011

<sup>108</sup> Avokati i Prokurimeve, “*Raporti përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, 2011*”

<sup>109</sup> Avokati i Prokurimeve, “*Raporti Vjetor në Kuvend për vitin 2010*” <http://www.avp.gov.al/ppadv/AnnualReports.aspx>. Parë për herë të fundit në korrik 2011.

<sup>110</sup> Avokati i Prokurimeve, “*Raporti Vjetor në Kuvend për vitin 2008*”

<sup>111</sup> Avokati i Prokurimeve, “*Raporti Vjetor për vitin 2009*”



dokumenteve standard të tenderit, etj. Gjithashtu AvP ka deklaruar se nuk është ngritur asnjë padi në Prokurori për ndonjë AK.

### 3.2.2. Kapacitetet

Institucioni i AvP ka buxhetin e vet të pavarur aprovuar nga Kuvendi. Megjithatë për vitin 2010, buxheti i këtij institucioni është reduktuar në krahasim me vitin paraardhës. Numri i personelit ishte 14 vetë gjatë vitit 2010, nga 15 që parashikon vendimi i Kuvendit.<sup>111</sup> Buxheti i pamjaftueshëm që i është caktuar këtij institucioni mund të ndikojë cilësinë dhe performancën në kohën e duhur të procedurave të monitorimit dhe hetimit.<sup>112</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se në raportin e paraqitur përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat, AvP ka theksuar nevojën për më shumë staf për të kryer veprimtarinë e tij në mënyrë efikase.<sup>113</sup> Për më tepër, trajnimi i vazhdueshëm i personelit mbetet prioritet i AvP.

### 3.2.3. Performanca

Megjithëse është krijuar vetëm së fundmi, AvP ka qenë aktiv dhe është përfshirë në disa ankime prej operatorëve ekonomikë që kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik. Gjatë vitit 2010, AvP ka marrë një numër më të ulët ankesash krahasuar me vitin 2009. AvP thekson se reduktimi i ankesave është ndikuar më së shumti nga konsolidimi i procedurave të prokurimit elektronik propozuar nga Qeveria, masë e cila ka ulur mundësitë për korrupsion si edhe ka rritur konkurrencën dhe transparencën e procedurave të prokurimit publik.<sup>114</sup>

Nga ana tjetër, statistikatat tregojnë se AvP ka kryer më shumë hetime gjatë vitit 2010 sesa gjatë vitit 2009.<sup>115</sup> Shumë prej këtyre hetimeve janë iniciuar nga vetë institucioni me përzgjedhje rastësore.<sup>116</sup> Këto rezultate përbëjnë një indikator për rolin pro-aktiv të institucionit për përmbushjen me sukses të detyrave të përcaktuara nga LPP si dhe për adresimin e rekomandimeve të rezolutave të hartuara nga Kuvendi. Për këtë çështje, nuk ka të dhëna që tregojnë përfshirjen ose jo të ndonjë prej institucioneve të sektorit të sigurisë në një procedurë hetimi të ndërmarrë nga AvP. Në kuadër të informimit dhe transparencës publike, AvP e përditëson rregullisht faqen zyrtare të internetit dhe mundëson aksesin në regjistrin elektronik të ankesave, raporteve vjetore dhe legjislacionit përkatës.

### 3.2.4. Arritjet, kontributi dhe sfidat

---

<sup>111</sup> Vendim i Kuvendit të Shqipërisë Nr. 116, datë 23.7.2007, "Për miratimin e strukturës dhe personelit të AP", i ndryshuar.

<sup>112</sup> Fokus Grup me përfaqësues të Institucioneve të Pavarura të Mbikëqyrjes, 13 tetor 2011.

<sup>113</sup> Avokati i Prokurimeve, "Raporti përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, 2011"

<sup>114</sup> Avokati i Prokurimeve, "Raporti Vjetor në Kuvend për vitin 2010"

<sup>115</sup> Në vitin 2010 AvP ka ndërmarrë 93 hetime dhe në vitin 2009 vetëm 59 të tillë. "Raporti vjetor i AvP në Kuvend 2009 dhe 2010."

<sup>116</sup> Avokati i Prokurimeve, "Raporti Vjetor në Kuvend për vitin 2010"

Miratimi i LPP dhe krijimi i AvP kanë kontribuar në fuqizimin e përgjithshëm të parimeve të transparencës, trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit në fushën e prokurimit publik. Në këtë kuadër, si rezultat i platformës së prokurimit elektronik dhe konsolidimit të veprimtarisë monitoruese të procedurave të prokurimit publik numri i ankesave tek AvP ka pësuar rënie.<sup>117</sup> Gjithashtu, Avokati i Prokurimeve dhe rekomandimet e tij bëhen më të nevojshëm përgjatë një procesi prokurimi sepse rekomandimet e tij ushtrojnë presion pozitiv mbi përfaqësuesit e AK për të qenë më të përgjegjshëm gjatë administrimit të procedurave të prokurimit.<sup>118</sup>

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2010 thekson se kuadri ligjor dhe ai institucional përbëjnë një bazë të mirë për zhvillimin e një sistemi të prokurimit publik efektiv dhe sipas standardeve të BE-së. Megjithatë, duhet të sigurohen kapacitetet e duhura në të gjitha organet që kryejnë prokurimin publik dhe duhet të vendosen përkufizime të qarta të përgjegjësisë dhe mekanizmave bashkëpunues.<sup>119</sup> Ndërsa Raporti për monitorimin e punës së AvP, që reflekton opinionet e operatorëve ekonomikë, thekson se krijimi i këtij institucioni përbën një hap përpara për mbrojtjen e të drejtave të operatorëve ekonomikë gjatë procedurave të prokurimeve publikë.<sup>120</sup>

Siç theksohet dhe më sipër, sfidat kryesore për AvP gjatë ushtrimit të funksioneve të tij monitorues dhe hetues janë buxheti i pamjaftueshëm dhe trajnimi e kualifikimi i burimeve njerëzore. Rrjedhimisht, për kapërcimin e këtyre vështirësive, AvP duhet të riorganizojë burimet e tij të brendshme për të maksimizuar efikasitetin dhe për të përmbushur me sukses detyrat e tij. Reduktimi i buxhetit të AvP mund të ulë nivelin e vëmendjes së veçantë që i kushtohet prokurimit në sektorin e sigurisë si sektor strategjik dhe delikat.

Gjithashtu, AvP është kritikuar në disa raste përse i përket pavarësisë së tij dhe politizimit duke qenë se titullari i këtij institucioni propozohet nga Këshilli i Ministrave. lidhje me pavarësinë e tij dhe politizimin meqenëse AvP propozohet nga Këshilli i Ministrave. Në këtë rast do të rekomandohej përfshirja e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe të atyre që janë të interesuar në këto procedura, në procesin e vendosjes dhe propozimit të AvP.<sup>121</sup>

Pavarësisht specifikave të institucioneve të sektorit të sigurisë, AvP i konsideron procedurat e prokurimit publik që kryhen nga këto institucione njësoj me procedurat e kryera nga çdo institucion tjetër publik. Prandaj, raportet vjetorë të AvP nuk i kushtojnë vëmendje të veçantë prokurimeve në sektorin e sigurisë.

Një çështje tjetër e rëndësishme për t'u theksuar lidhet me veprimtarinë e AvP. Meqenëse LPP nuk përfshin prokurimin për blerjen e municioneve, armëve dhe

---

<sup>117</sup> Po aty.

<sup>118</sup> Qendra për Zhvillim dhe Demokratizimin e Institucioneve, “*Monitorimi i punës së Avokatit të Prokurimeve*”. Raporti përfundimtar, mars 2011. [http://albania.usaid.gov/skedaret/1304066543-ProcurementAdvocate\\_En.pdf](http://albania.usaid.gov/skedaret/1304066543-ProcurementAdvocate_En.pdf). Parë për herë të fundit në shtator 2011.

<sup>119</sup> Komisioni i Komuniteteve Europiane, “Raporti analitik që shoqëron Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin: Opinion i Komisionit mbi Aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë”, 9 nëntor 2010, Bruksel [http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargement/47f\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargement/47f_en.htm), parë në shtator 2011.

<sup>120</sup> Qendra për Zhvillim dhe Demokratizimin e Institucioneve, “*Monitorimi i punës së Avokatit të Prokurimeve*”. Raporti përfundimtar, mars 2011.

<sup>121</sup> Po aty. Ky është gjithashtu nga rekomandimet që ka dalë nga raporti për monitorimin e punës së AvP-së.

shërbimeve në fushën e ushtrisë dhe mbrojtjes, AvP nuk mund të monitorojë dhe hetojë këto prokurime. Rrjedhimisht, parimet e transparencës dhe llogaridhënies cenohen duke çuar në korrupsion, praktika abuzive dhe të paligjshme. Në këtë rast rekomandimi do të ishte përmirësimi i legjislacionit në fuqi për t'i mundësuar AvP monitorimin dhe hetimin e këtyre procedurave të prokurimit.

### **3.3. Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive**

Ky kapitull vlerëson rolin e Inspektoriatit të Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive (ILKDP), si një prej Institucioneve të Pa-varur të Mbikëqyrjes duke u përqendruar veçanërisht tek aktiviteti mbikëqyrës i këtij institucioni mbi institucionet e sektorit të sigurisë. Gjatë analizës i kushtohet vëmendje kontekstit në të cilin është themeluar institucioni, kuadrin kushtetues dhe ligjor në bazë të të cilit funksionon ILKDP, kapaciteteve të tij, performancës dhe kontributeve kryesorë të këtij institucioni si dhe problemeve dhe sfidave të ardhshme të ILKDP.

#### 3.3.1. Themelimi

ILKDP u themelua në vitin 2003 nga Kuvendi për të mbikëqyruar zbatimin dhe praktikimin e dy ligjeve në luftën kundër korrupsionit, ligjit të deklarimit të pasurive (2003) dhe atij të konfliktit të interesave (2005).<sup>122</sup>

Ligji për deklarimin e pasurive pajis ILKDP me kompetenca për administrimin e deklarimeve të pasurive, detyrimeve financiare si dhe për kryerjen e hetimeve periodike dhe të plota të këtyre deklaratave. ILKDP bashkëpunon me strukturat e auditit dhe institucionet e tjera përgjegjës për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik gjatë kryerjes së detyrave që i përcakton ligji.

Me miratimin e ligjit për konfliktin e interesit në vitin 2005, ILKDP është autoriteti qendror përgjegjës në këtë fushë. Ky ligj ka zgjeruar kompetencat e institucionit duke përfshirë drejtimin dhe përmirësimin e politikave; ofrimin e asistencës teknike për të këshilluar dhe mbështetur iniciativat ligjore të ndërmarra nga institucionet publike për parandalimin e konfliktit të interesave si edhe për monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit në praktikë të këtij ligji.<sup>123</sup>

#### 3.3.2. Kuadri Ligjor

Dy janë Ligjet që menaxhojnë funksionimin e ILKDP. Ligji Nr. 9049 përcakton procedurat dhe rregullat për deklarimin dhe kontrollin e pasurive si dhe legjitimitetin e

---

<sup>122</sup>Ligj Nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve, dhe të disa Nëpunësve Publikë” dhe, Ligj Nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e Konfliktit të Interesave gjatë ushtrimit të Funksioneve Publikë”

<sup>123</sup>Ligj Nr. 9367, Nenet 41 dhe 42.

mjeteve me të cilat ato janë krijuar, për zyrtarët e zgjedhur, nëpunësit publikë, familjet e tyre dhe personat e lidhur me ta.<sup>124</sup> Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit miratuar në vitin 2005 i përcakton ILKDP kompetenca të tjera të rëndësishme përse i përket ushtrimi të kontrolleve dhe aktiviteteve të tjerë për parandalimin e konfliktit të interesit.

### *3.3.2.1. Mandati*

Inspektori i Përgjithshëm (IP) zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës, ka një mandat pesë vjeçar, dhe gëzon të njëjtat privilegje dhe pagë si anëtarët e Gjykatës së Lartë.<sup>125</sup> IP udhëheq ILKDP gjatë kontrollit të deklarimeve të pasurive dhe legjitimitetit të burimeve të krijimit të tyre të deklaruara nga subjektet e këtij ligji dhe njofton rast pas rasti Presidentin, Këshillin e Ministrave, Kryeministrin dhe drejtuesit e institucioneve qendrorë për parregullsitë e verifikuara në deklaratimet e pasurive që dorëzohen nga të punësuarit e këtyre institucioneve.<sup>126</sup> Kompetencat e ILKDP, siç përcaktohen nga Neni 17 i të njëjtit ligj, përfshijnë ushtrimin e kontrollit të drejtpërdrejtë mbi deklaratat që i adresohen këtij institucioni, mbledhjen e të dhënave dhe kryerjen e hetimeve administrative.

Me miratimin e ligjit për konfliktin e interesave,<sup>127</sup> ILKDP është përgjegjëse për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesave ndërmjet zyrtarëve që ushtrojnë funksione publikë. Ky ligj është ndryshuar nga një tjetër ligj.<sup>128</sup> Në kuadër të konfliktit të interesave, IP është përgjegjës për menaxhimin dhe përmirësimin e politikave dhe mekanizmave për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit, duke ofruar asistencë teknike për të këshilluar dhe mbështetur iniciativat ligjore dhe nënligjore të ndërmarra nga institucione publikë për parandalimin e konfliktit të interesit; duke këshilluar zyrtarët e veçantë, eprorët dhe institucionet e larta, me kërkesën e tyre, për raste specifike të shfaqjes së konfliktit të interesave si dhe për deklarata periodike të konfliktit të interesit.<sup>129</sup> Zyrtarët që janë subjekt i ligjit për konfliktin e interesit janë po ata që përcaktohen nga Neni 3 i Ligjit Nr. 9049 për deklarimin e pasurive.

### *3.3.2.2. Pavarësia*

Pavarësia e IP të ILKDP përcaktohet nga Neni 13 i Ligjit Nr. 9049 i cili specifikon se gjatë ushtrimit të detyrave të tij IP i ndalohet ushtrimi i funksioneve të tjerë publikë, ushtrimi i aktiviteteve politikë dhe qenia anëtar i ndonjë partie politike. Deri tani nuk është identifikuar asnjë rast serioz i mosrespektimit të kritereve të tilla.

### *3.3.2.3. Juridiksioni mbi institucionet e sektorit të sigurisë*

---

<sup>124</sup>Ligj Nr. 9049, Neni 1.

<sup>125</sup>Ligj Nr. 9049, Nenet 11 (2) dhe (3).

<sup>126</sup>Ligj Nr. 9049, Neni 15.

<sup>127</sup>Ligj Nr. 9367, Neni 43.

<sup>128</sup>Ligj Nr. 9475, datë 9.2.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike"

<sup>129</sup>Ligj Nr. 9367, Neni 43.

Përsa i përket zyrtarëve të sektorit të sigurisë, ligji për deklarimin e pasurive parashikon se detyrimi për deklarimin e pasurisë dhe burimeve të krijimit të saj është i vlefshëm për Ministrat dhe Zëvendësministrat, Drejtorët e Drejtorive dhe Komandantët e FA në Ministrinë e Mbrojtjes (MM) si edhe për Shërbimin Informativ të Shtetit (ShiSh), Prokurorët në të gjitha nivelet, drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e Komisariateve në drejtoritë qendrore dhe ato rajonale të Policisë së Shtetit (PSh).<sup>130</sup> Po i njëjti përcaktim është i vlefshëm edhe në rastin e ligjit për konfliktin e interesit.

### 3.3.3. Kapacitetet

Struktura organizative e ILKDP përcaktohet nga IP dhe miratohet nga Kuvendi, punonjësit e këtij institucioni gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe institucioni ka një buxhet të pavarur që aprovohet nga Kuvendi.<sup>131</sup> Struktura aktuale e ILKDP është e plotësuar dhe përbëhet nga 45 punonjës nga të cilët 11 janë Inspektorë të Lartë dhe 11 janë Zëvendës inspektorë të Lartë. Ata janë të organizuar në dy seksione kryesorë njëri prej të cilëve merret me verifikimin e pasurive dhe tjetri me konfliktin e interesit.<sup>132</sup> Megjithatë ILKDP i nevojiten më shumë kapacitete të brendshme dhe të jashtme për forcimin e hetimeve si dhe për përmirësimin e kanaleve të komunikimit përsa i përket pasurive të zyrtarëve që ndodhen jashtë shtetit.<sup>133</sup>

### 3.3.4. Performanca dhe zbatimi i legjislacionit

Gjatë vitit 2008, duke synuar të forcojë kapacitetet e saj hetuese për luftën kundër korrupsionit, ILKDP ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shteti dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Për më tepër sipas Neneve 17 dhe 18 të Ligjit Nr. 9367, ILKDP ka ndërmarrë kontrole të plota për deklaratat e interesit të 642 zyrtarëve prej të cilave 152 deklarata u përzgjedhën me short në vitin 2008.<sup>134</sup> Nga këto 25 deklarata i përkasin zyrtarëve të sektorit të sigurisë ku përfshihen: 14 prokurorë, 2 zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes (MM), 6 zyrtarë të Policisë së Shtetit dhe 3 zyrtarë të ShiSh.<sup>135</sup>

Gjatë vitit 2009 ILKDP ka zhvilluar trajnime me përfaqësues të institucioneve publikë dhe Autoritetet Përgjegjëse (AuP) për rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit. Përsa i përket institucioneve të sektorit të sigurisë

---

<sup>130</sup>Ligj Nr. 9049, Nenet 3 (a), (ç), (d) dhe (e).

<sup>131</sup>Ligj Nr. 9049, Neni 16.

<sup>132</sup> Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “*Letër zyrtare për Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim*” 26. 9. 2011.

<sup>133</sup> Diskutim në Fokus Grup me përfaqësues të IPM, 13 tetor 2011.

<sup>134</sup> Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “*Raport vjetor në Kuvend për vitin 2008*” <http://www.hidaa.gov.al/raport-2008/?lang=en>. Parë në tetor 2011.

<sup>135</sup>“Emrat e 152 zyrtarëve që do t’ju verifikohen pasuritë” *Gazeta Albania*, 28 maj 2008. <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/47555/titulli/Ja-emrat-e-152-zyrtareve-qe-do-tu-verifikohen-pasurite>. Parë në tetor 2011

theksohet se pjesëmarrës të këtyre trajnimeve ishin edhe zyrtarë të MB.<sup>136</sup> Për më tepër ILKDP, pas kontrolleve të deklaratave pas lënies së detyrës ka aplikuar gjoba për 11 ish-subjekte duke përfshirë edhe një ish-drejtor në Ministrinë e Mbrojtjes.<sup>137</sup> Lista e deklaratave të përzgjedhura me short për kontroll të plotë gjatë vitit 2009 për konfliktin e interesit përfshin 165 zyrtarë nga të cilët 14 i përkasin institucioneve të sektorit të sigurisë. Nga këta, 12 janë Prokurorë, 1 është zyrtar në MM dhe 1 zyrtar i MB.<sup>138</sup>

Gjatë vitit 2010, ILKDP, në bashkëpunim me AuP e MM ka identifikuar 10 raste të dyshuar për konflikt interesi brenda kësaj ministrie.<sup>139</sup> Për vitin 2010, lista e deklaratave të konfliktit të interesit që i nënshtrohen kontrollit të plotë nga ILKDP të përzgjedhur me short përfshin 190 zyrtarë nga të cilët 30 i përkasin sektorit të sigurisë. Nga këta të fundit, 17 janë prokurorë, 4 janë efektivë të PSh-së, 3 janë pjesë e ShiSh, 1 është ish-zyrtar në MM dhe 3 janë zyrtarë aktualë në MB.<sup>140</sup> Për vitin 2011, 188 subjekte u përzgjedhën me short për kontroll të plotë nga të cilët 28 i përkasin sektorit të sigurisë ku përfshihen 16 prokurorë, 7 zyrtarë të PSh, 3 zyrtarë të MM, 1 zyrtar i MB dhe një efektiv i ShiSh.<sup>141</sup>

Në përgjithësi, raportet e ILKDP ndjekin një strukturë të qartë që është përmirësuar nga viti në vit. Megjithatë ato përmbajnë statistika të të gjitha llojeve duke mos bërë një ndarje të qartë për sektorët/institucionet specifike. Kjo e vështirëson kryerjen e një analize në bazë sektori bazuar në këto raporte. Përsa i përket sektorit të sigurisë, siç tregohet dhe nga analiza e mësipërme, ILKDP ushtron kompetencat e saj edhe për institucionet e këtij sektori. Këto institucione trajtohen në mënyrë të njëjtë nga ILKDP ashtu sikundër institucionet në sektorë të tjerë. Në lidhje me trajtimin e veçantë të institucioneve të sektorit të sigurisë përfaqësues të ILKDP gjatë fokus grupeve u shprehën se kjo konsiderohet si e parakohshme për momentin.<sup>142</sup>

### 3.3.5. Arritjet, kontributet dhe sfidat

Miratimi i ligjit për deklarimin e pasurive në vitin 2003 dhe i ligjit për konfliktin e interesave në vitin 2005 perceptohen si hapa domethënës në rritjen e luftës kundër korrupsionit. Këto ligje ofrojnë rregullore të kuptueshme dhe rregulla dhe detyrime të qarta si dhe kufizime strikt për interesat personale të politikanëve si dhe për zyrtarët e mesëm

---

<sup>136</sup>Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2009” <http://www.hidaa.gov.al/raport-2011/?lang=en>. Parë në tetor 2011.

<sup>137</sup>Faqja zyrtare e internetit e ILKDP, “ILKDP gjatë 11 subjekte për vonesa në deklarime” <http://www.hidaa.gov.al/22-nentor-2009/>. Parë në tetor 2011.

<sup>138</sup>Sulçe, Shaban. “166 zyrtarët që do të hetohen plotësisht nga ILKDP”, Gazeta Albania, 30 prill 2009. <http://www.gazeta-albania.net/nees.php?id=16092>. Parë në tetor 2011.

<sup>139</sup> Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2010” <http://www.hidaa.gov.al/raport-2010/?lang=en>. Parë në tetor 2011.

<sup>140</sup> Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “Lista e subjekteve të përzgjedhur me llotari për kontroll të plotë gjatë vitit 2010” [http://www.hidaa.gov.al/njofitime/subjektet\\_perzgjedhur\\_shorti\\_2010.pdf](http://www.hidaa.gov.al/njofitime/subjektet_perzgjedhur_shorti_2010.pdf). Parë në korrik 2011.

<sup>141</sup> Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “Lista e subjekteve të përzgjedhur me llotari për kontroll të plotë për vitin 2011”

<sup>142</sup>Diskutim në Fokus Grup me përfaqësues të IPM, 13 tetor 2011.

dhe të lartë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, mundësojnë masa administrative të ashpra në rast shkeljeje të ligjit si dhe lidhje me legjislacionin kriminal.<sup>143</sup>

Kontributi kryesor i ILKDP ka qenë identifikimi, bërja publike dhe ekspozimi i vazhdueshëm i rasteve të konfliktit të interesit dhe të parregullsive për deklarimin me pasurive.<sup>144</sup> Gjatë vitit 2009, firmosja e memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet ILKDP dhe NjIF konsiderohet si një hap i suksesshëm drejt rritjes së luftës kundër korrupsionit.<sup>145</sup> Gjatë vitit 2010, ILKDP ka dhënë rezultate të kënaqshme përsa i përket marrjes së masave administrative kundër nëpunësve civilë të cilët nuk kanë dorëzuar deklaratat e tyre dhe ka njoftuar Prokurorinë në raste të mosveprimit sipas ligjit.<sup>146</sup>

ILKDP nuk ka mekanizmat e tij hetimorë dhe i duhet të bashkëpunojë me organe të tjerë për zhvillimin dhe finalizimin e hetimeve të saj. Për më tepër rastet që i janë dërguar Prokurorisë shpesh nuk hetohen ose pushohen hetimet.<sup>147</sup> Për shembull, në vitin 2009 nga 14 kërkesa për fillimin e proceduarve penale që i janë dërguar Prokurorisë, 3 janë pushuar dhe të tre këto raste i korrespondonin zyrtarëve të lartë. Në vitin 2010 nga 18 raste të çuara në Prokurori, 7 janë pushuar.<sup>148</sup> Vështirësitë me të cilat përballet ILKDP gjatë hetimit vërehen edhe nga një kërkesë që ky institucion i ka bërë PAMECA për ndihmë gjatë zhvillimit të hetimeve për verifikimin e aseteve financiare që ndodhen jashtë vendit.<sup>149</sup>

Edhe pse është një aktor i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, ILKDP ka burime të kufizuara për të ndërmarrë inspektime të detajuara dhe kontrole të plota të deklaratave të pasurive që plotësohen nga zyrtarët.<sup>150</sup> Kjo tregon se nevojitet një forcim më i madh i kapaciteteve investigative të ILKDP që ai të përmbushë detyrimet si një institucion i pavarur i mbikëqyrjes.

Shumica e institucioneve që duhet të hetojnë rastet e identifikuar prej ILKDP janë vetë pjesë e kontroleve të kryera nga ky institucion. Edhe pse përfaqësuesit e ILKDP nuk e pranuan këtë gjatë diskutimit në fokus grup, ekziston frika se konkretizimi i punës së ILKDP mund të pengohet duke qenë se ajo mbështetet për zbatimin e vendimeve të saj tek institucionet hetimore që janë edhe subjekte të kontrollit të kryer nga ky institucion si Prokuroria, Policia dhe Gjyqësori.

Ligji për deklarimin e pasurive dhe ai për konfliktin e interesit përmbledhin një numër të madh subjektesh dhe zyrtarësh publikë si pjesë e tyre. Prandaj, ekziston shqetësimi se

---

<sup>143</sup>Casals and Associates dhe Claro and Associates, “Shqipëria: Raport mbi arritjet dhe draft vlerësim kapacitetesh”, (2010), fq. 59.

<sup>144</sup>SIDA, “Studim anti-korrupsion për Shqipërinë”, (2008), fq. 30.

<sup>145</sup> Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “Raport analitik që shoqëron Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Opinion i Komisionit për Aplikimin për Anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë”, nëntor 2009, fq. 46.

<sup>146</sup> Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “Raport analitik që shoqëron Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Opinion i Komisionit për Aplikimin për Anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë”, nëntor 2010, Bruksel, fq. 23.

<sup>147</sup>Gjipali, Gledis, “Shqipëria: Shtetet në tranzicion 2011” Freedom House, fq. 65.

<sup>148</sup> ILKDP, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2009” dhe, ILKDP, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2010”

<sup>149</sup> Faqja e internetit e ILKDP-së, “Çështje korruptive prej 4 milionë Eurosh. Në Shqipëri gjobiten me 2000 Dollarë” <http://www.hidaa.gov.al/11-qershor-2011>, Parë në tetor 2011.

<sup>150</sup> Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “Progres Raporti i Shqipërisë për vitin 2010. Shoqërues i dokumentit komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2011-2012”, tetor 2011, Bruksel [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/al\\_rapport\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/al_rapport_2011_en.pdf) . parë në tetor 2011.

ILKDP mund të mos ketë kapacitetet organizative të duhura për adresimin e të gjithë subjekteve. Për këtë arsye, sugjerohet ngushtimi i qëllimit të ligjeve duke u përqendruar vetëm tek zyrtarët e nivelit të lartë.<sup>151</sup>

Përsa i përket zyrtarëve të sektorit të sigurisë duket se ata nuk trajtohen në mënyrë të veçantë nga ILKDP. Për më tepër një trajtim i veçantë i sektorit të sigurisë konsiderohet si prematurë edhe nga vetë përfaqësuesit e ILKDP.<sup>152</sup> Duke pasur parasysh natyrën e veçantë të sektorit të sigurisë dhe specifikat e tij mund të ishte e dobishme që në terma afatmesëm dhe afatgjatë të krijoheshin kushtet për krijimin e një sektori të veçantë në ILKDP i cili do të merrej në veçanti me institucionet e sigurisë.

Viti	Deklarata të zgjedhura me short	Deklarata të sektorit të sigurisë të përzgjedhura me short
2008	152 (100%)	25 (16.45%)
2009	165 (100%)	14 (8.48%)
2010	190 (100%)	30 (15.79%)
2011	188 (100%)	28 (14.89%)

Tabela 1: Numri i deklarimeve të pasurisë kontrolluar nga ILKDP për periudhën 2008 - 2011

## 4. Konkluzione

IPM janë pjesë e rëndësishme e qeverisjes demokratike dhe luajnë një rol të rëndësishëm në kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Megjithatë performanca e tyre e suksesshme lidhet ngushtë me nivelin e pavarësisë që gëzojnë këto institucione. Gjetjet e këtij studimi, nxjerrin në pah se niveli i pavarësisë së IPM varion.

Një element lehtësisht i dallueshëm është procedura e përzgjedhjes të titullarëve të IPM. Duke pasur parasysh se IPM janë institucione monokratike procedura e zgjedhjes së kryetarëve ka rëndësi të veçantë për pavarësinë e tyre. Raportet sugjerojnë se procedura e përzgjedhjes duket se përcakton gjithashtu dhe marrëdhëniet e IPM me Kuvendin. I gjithë koncepti i IPM mbështetet tek pavarësia që ato gëzojnë kundrejt ekzekutivit të cilin ato duhet ta kontrollojnë. Prandaj çdo përfshirje e ekzekutivit jo vetëm në zgjedhje por edhe në autoritetin për të nxjerrë akte normative ose për propozimin e buxhetit të këtyre institucioneve, çënon pavarësinë e tyre.

Tabela e mëposhtme prezanton kronologjinë e themelimit të IPM dhe procedurën dhe mekanizmat me anë të të cilave zgjidhen titullarët e tyre. (Tabela 2).

<sup>151</sup> PACA, “ Studim teknik. Përmbledhje e përfundimeve të takimit ndërmjet ekipit të PACA dhe Inspektoratit të Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive në lidhje me komentet dhe ndryshimet e ligjit për konfliktin e interesit dhe atë për deklarimin e pasurive”, 2010, 4

<sup>152</sup> .Sipas pikëpamjeve të ngritura gjatë fokus grupit që u zhvillua për këtë studim.



	KLSH	AP	ILDKP	AvP	KMDhP	KMD
<b>Krijuar</b>	1997	1998	2003	2006	2008	2010
<b>Gëzon Imunitet</b>	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Jo
<b>Propozohet</b>	Nga Presidenti i Republikës	Nga jo më pak se një e treta e deputetëve	Nga Presidenti i Republikës	Nga Këshilli i Ministrave	Nga Këshilli i Ministrave	Nga numër i pacaktuar deputetësh
<b>Zgjidhet</b>	Me shumicë absolute	Nga tre të pestat e të gjithë deputetëve	Me shumicë absolute të gjithë deputetëve	Me shumicë absolute	Me shumicë absolute	Me shumicë absolute të gjithë deputetëve
<b>Shkarkohet</b>	Nga dy të tretat e të gjithë deputetëve	Nga tre të pestat e të gjithë deputetëve	Me shumicë absolute të gjithë deputetëve	Me shumicë absolute	Me shumicë absolute	Me shumicë absolute të gjithë deputetëve
<b>Propozohet Shkarkimi</b>	Nga Presidenti i Republikës	Nga jo më pak se një e treta e të gjithë deputetëve	Nga jo më pak se një e treta e të gjithë deputetëve	E pa përcaktuar në ligj	E pa përcaktuar në ligj	Nga jo më pak se një e treta e të gjithë deputetëve

*Tabela 2: Viti i krijimit dhe mekanizmat e zgjedhjes së titullarëve të IPM*


Siç shihet edhe nga tabela, procedura e përzgjedhjes së titullarëve ndryshon sipas kohës së themelimit të institucionit. Procedura e përzgjedhjes së IPM të themeluara më herët mundëson më tepër pavarësi, ndërsa për IPM e themeluara më vonë vërehet një përfshirje e ekzekutivit gjatë përzgjedhjes së titullarit të institucionit. Përveç kësaj, procedura e zgjedhjes së titullarit në IPM e themeluara më herët përmban elementin e shumicës së cilësuar dhe i jep më shumë pavarësi këtyre institucioneve, ndërsa tek IPM e themeluara më vonë vërehet një tendencë për braktisjen e votimit me shumicë të cilësuar si një mekanizëm për zgjedhjen e tyre.

Një tjetër element i rëndësishëm që garanton pavarësinë e IPM është financimi i tyre. Është diskutuar gjerësisht nga media dhe shoqëria civile tendenca e ekzekutivit për të ushtruar presion kundrejt IPM nëpërmjet buxhetit. Në këtë kuadër, nuk ekzistojnë shumë variacione duke qenë se buxheti i të gjithë IPM me përjashtim të KLSH propozohet nga ekzekutivi. Që prej vitit 2008 KLSH është e vetmja IPM procedura për përcaktimin e buxhetit të të cilit nuk kryhet me pjesëmarrjen e qeverisë.

Përsa i përket rolit të IPM në kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të sektorit të sigurisë, paraqitja e IPM në këtë aspekt është e më e dobët sesa paraqitja e tyre e përgjithshme. Përveç problemit të diskutuar më sipër, kjo lidhet edhe me faktin se tradicionalisht sektori i sigurisë ka gëzuar një pozitë të veçantë brenda strukturave qeverisëse. Si rrjedhojë legjislacioni, struktura dhe praktikat e mbikëqyrjes kanë qenë më të dobëtat dhe më pak të përcaktuara në këtë sektor. Ligjet për IPM nuk e kanë tejkaluar këtë problem të dukshëm dhe nuk përmbajnë klauzola specifike për kontrollin e institucioneve të sektorit të sigurisë.

Një çështje përfundimtare i përket perceptimeve të publikut për IPM. Ekzistojnë vetëm sondazhe të pjesshme për të matur këtë aspekt, por edhe të dhënat që janë të disponueshme nuk duket se vendosin IPM në ndonjë pozicion më të favorshëm se sa institucionet e tjerë

shtetërorë. Grafiku më poshtë tregon pritshmëritë e ulëta që publiku ka lidhur me KLSH dhe ILKDP për rolin e tyre si institucione që luftojnë korrupsionin. (Grafiku 4).<sup>153</sup>



Grafiku 4: Masa në të cilën institucionet ndihmojnë në luftën kundër korrupsionit  
Burimi: “Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe përvoja, Anketim 2010, Instituti për Zhvillim Kërkim dhe Alternativa” (IDRA)

## 5. Rekomandime

Me poshtë paraqiten disa rekomandime të cilat janë nxjerrë në vijim t:ë këtij studimi dhe nga diskutimet me aktorë të interesuar të institucioneve të pavarura dhe më gjerë.

1. Kuvendi duhet të rishikojë legjislacionin për institucionet e pavarura të mbikëqyrjes për të fuqizuar pavarësinë e tyre dhe për të lehtësuar ndërveprimin e IPM me sektorin e sigurisë.
2. Kuvendi duhet të vendosë marrëdhënie pune më të mira dhe duhet të mundësojë funksionimin e mekanizmave të matshëm për vlerësimin e performancës së institucioneve të pavarura të mbikëqyrjes.
3. Institucionet e pavarura të mbikëqyrjes duhet të jenë të aftë të propozojnë buxhetin e tyre në Kuvend.
4. Institucionet e pavarura të mbikëqyrjes duhet të përqendrohen më shumë tek mbikëqyrja e sektorit të sigurisë duke pasur parasysh specifikat e këtij sektori, duke përmirësuar mekanizmat mbikëqyrës dhe duke zhvilluar resurse më të afta.

<sup>153</sup> Në grafik ky institucion përmendet si Kontrolli i Lartë i Shtetit

5. Përveç ankesave nga publiku, institucionet e pavarura të mbikëqyrjes duhet të përfshihen më shumë në veprime pro-aktive.
6. Në përgjithësi, institucionet e pavarura të mbikëqyrjes duhet të bëjnë më shumë për të tërhequr vëmendjen dhe siguruar mbështetjen e publikut.
7. Titullarët e institucioneve të pavarura të mbikëqyrjes nuk duhen propozuar nga ekzekutivi por nga institucione më të pavarura si Kuvendi dhe/ose Presidenti për të garantuar ndarjen e pushteteve dhe pavarësinë e tyre nga ekzekutivi.
8. Kuvendi duhet të përdorë më shumë procedurën e shumicës së cilësuar gjatë zgjedhjes dhe/ose shkarkimit nga detyra të kryetarëve dhe anëtarëve të IPM.

## 6. Bibliografia

### Ligje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligj Nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurave Penale.”

Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës.”

Ligj Nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurave Civile.”

Ligj Nr. 8270, datë 23.12. 1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit.”

Ligj Nr. 8454, datë 04.2.1999, “Për Avokatin e Popullit.”

Ligj Nr. 8457, datë 11.2.1999, “Mbi informacionin e klasifikuar si ‘Sekret Shtetëror’.”

Ligj Nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative.”

Ligj Nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare.”

Ligj Nr. 8517, datë 22.7.1999, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.”

Ligj Nr. 8599, datë 1.6.2000, “Mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 8270, datë 23.12.1997, Për Kontrollin e Lartë të Shtetit.”

Ligj Nr. 8600, datë 10.4.2000, “Për një shtesë në Ligjin Nr. 8454, datë 4.2.1999, Për Avokatin e Popullit.”

Ligj Nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për mbledhjen, administrimin dhe mbrojtjen e informacionit Policor të klasifikuar.”

Ligj Nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve, dhe të disa Nëpunësve Publikë.”

Ligj Nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për Arkivat.”

Ligj Nr. 9287, datë 7.10.2004, “Për Protokollin shtesë të Konventës për mbrojtjen e Individëve lidhur me Procedimin Automatik të të dhënave personale në lidhje me Autoritetet Mbikëqyrëse dhe rrjedhjeve ndër kufitare.”

Ligj Nr. 9288, datë 7.10.2004, “Për ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e Individëve në Lidhje me përpunimin e të Dhënave Personale.”

Ligj Nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë ushtrimit të Funksioneve Publike.”

Ligj Nr. 9398, datë 12.5.2005, “Mbi disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit Nr. 8454, datë 4.2.1999, Për Avokatin e Popullit, ndryshuar me Ligj Nr. 8600, datë 10.04.2000.”

Ligj Nr. 9475, datë 8.2.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave gjatë ushtrimit të Funksioneve Publike.”

Ligj Nr. 9541, datë 22.5.2006, “Për disa ndryshime të ligjit mbi Informacionin e Klasifikuar si ‘Sekret Shtetëror’.”

Ligj Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimet Publike.”

Ligj Nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për Koncesionet.”

Ligj Nr. 9800, datë 10.09.2007, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 për Prokurimet Publike.”

Ligj Nr. 9855, datë 26.12.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 për Prokurimet Publike ndryshuar me Ligj Nr. 9800, datë 10.09.2007.”

Ligj Nr. 9874, datë 14.02.2008, “Për ankandin publik.”

Ligj Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të dhënave Personale.”

Ligj Nr. 9888, datë 10.03.2008, “Për disa ndryshime në Ligjin 8328, datë 16.4.1998 për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve të ndryshuar.”

Ligj Nr. 10025, datë 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009.”

Ligj Nr. 10170, datë 22.10.2009, “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 mbi Prokurimet Publike të ndryshuar.”

Ligj Nr. 10190, datë 26. 11. 2009, “Për Buxhetin e vitit 2010.”

Ligj Nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen ndaj diskriminimit.”

Ligj Nr. 10309, datë 22.07.2010, “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 mbi Prokurimet Publike të ndryshuar.”

## **Vendime**

Gjykata Kushtetuese, Vendim Nr. 212, datë 29.10.2002

Gjykata Kushtetuese, Vendim Nr. 49, datë 31.7.2000

Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 94, datë 15.2.2006 “Për aprovimin e rregullores rreth funksioneve dhe procedurave të kontrollit administrativ të brendshëm dhe anti korrupsionit të Këshillit të Ministrave.”

Këshilli i Ministrave, Vendim Nr. 121, datë 2.2.2009, “Për ruajtjen e informacionit të klasifikuar si ‘Sekret Shtetëror’ në fushën industriale.”

Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 29 datë 9.7.2007, “Për themelimin e shërbimit për monitorimin e institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin.”

Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 34, datë 20.5.2010, “Mbi aprovimin e strukturës organizative dhe klasifikimit të pagave për punonjësit e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.”

Kuvendi i Shqipërisë, Vendim Nr. 116, datë 23.7.2007, “Për aprovimin e strukturës dhe stafit të Avokatit të Prokurimeve.”

## **Urdhra**

Këshilli i Ministrave, Urdhër Nr. 57, datë 29.4.2011, “Mbi firmosjen e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre të cilat kanë detyrimin për të marrë masa në kuadër të luftës kundër diskriminimit dhe Komisionerit për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit.”

## **Burimet Parësore**

Avokati i Popullit, Rekomandim Nr. 177 datë 13.06.2006, “Mbi aprovimin e rregullores tip për të drejtën e informimit.” Drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave në datë 16.7.2007.

<http://www.avokatipopullit.gov.al/Rekomandime/Rek1%2016072007.htm>

Avokati i Popullit, “*Raport vjetor në Kuvend, 2000.*”

Avokati i Popullit, “*Raport vjetor në Kuvend, 2001.*”

Avokati i Popullit, “*Raport vjetor në Kuvend, 2002.*”

Avokati i Popullit, “*Raport vjetor në Kuvend, 2003.*”

Avokati i Popullit, “*Raport vjetor në Kuvend, 2004.*”

Avokati i Popullit, “*Raport vjetor në Kuvend, 2005.*”

Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend, 2006.”

Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend, 2007.”

Avokati i Popullit, “Raport vjetor në Kuvend, 2008.”  
[http://www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/Raporti\\_2008.pdf](http://www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/Raporti_2008.pdf). Parë në tetor 2008

Avokati i Popullit, “Raport Vjetor në Kuvend, 2009”

Avokati i Popullit, “Raport Vjetor në Kuvend, 2010.”

Avokati i Popullit, “Shënime nga Raportimi i Avokatit të Popullit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, 2008.”  
[http://www.parlament.al/web/Procesverbalet\\_10044\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Procesverbalet_10044_1.php). Parë në gusht 2011

Avokati i Popullit, “Shënime nga Raportimi i Avokatit të Popullit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, 2009.”  
[http://www.parlament.al/web/Procesverbalet\\_10044\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Procesverbalet_10044_1.php). Parë në gusht 2011

Avokati i Popullit, “Shënime nga Raportimi i Avokatit të Popullit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, 2010.”  
[http://www.parlament.al/web/Procesverbalet\\_10044\\_1.php](http://www.parlament.al/web/Procesverbalet_10044_1.php). Parë në tetor 2011

Avokati i Prokurimeve, “Raporti përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, 2011.”

Avokati i Prokurimeve, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2008”

Avokati i Prokurimeve, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2009.”

Avokati i Prokurimeve, “Raport vjetor në Kuvend për vitin 2010.”  
<http://www.avp.gov.al/ppadv/AnnualReports.aspx>. Parë në korrik 2011.

Bordi Ndërkombëtar i Audituesve për NATO,  
[http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_55937.htm](http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_55937.htm). Parë në shtator 2011

Diskutim në Fokus Grup me përfaqësues të IPM, 13 tetor 2011.

Faqja zyrtare e internetit e ILKDP-së, “ILKDP gjobit 11 subjekte për vonesa në deklaramë.” <http://www.hidaa.gov.al/22-ntor-2009/>. Parë në tetor 2011.

Intervistë me Artur Lazebeun, Shef Kabineti i Avokatit të Popullit

Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “Letër zyrtare për Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim.”, 26.9.2011

Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “*Lista e subjekteve të përzgjedhur me llotari për kontroll të plotë gjatë vitit 2010.*”

[http://www.hidaa.gov.al/njofitime/subjektet\\_perzgjedhur\\_shorti\\_2010.pdf](http://www.hidaa.gov.al/njofitime/subjektet_perzgjedhur_shorti_2010.pdf), Parë në korrik 2011.

Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “*Lista e Subjekteve të përzgjedhur me llotari për kontroll të plotë gjatë vitit 2011.*”

[http://www.hidaa.gov.al/njofitime/subjektet\\_perzgjedhur\\_shorti\\_2011.pdf](http://www.hidaa.gov.al/njofitime/subjektet_perzgjedhur_shorti_2011.pdf), Parë në korrik 2011

Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “*Raport Vjetor në Kuvend për vitin 2008.*” <http://www.hidaa.gov.al/raport-2008/?lang=sq>. Parë në tetor 2011.

Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “*Raport vjetor në Kuvend për vitin 2009.*” <http://www.hidaa.gov.al/raport-2009/?lang=en>. Parë në tetor 2011

Inspektoriati i Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive, “*Raport vjetor në Kuvend për vitin 2010.*” <http://www.hidaa.gov.al/raport-2010/?lang=en>. Parë në tetor 2011.

INTOSAI Lima Declaration

[http://www.intosai.org/en/portal/documents/intosai/general/limaundmexikodeclaration/lima\\_declaration/](http://www.intosai.org/en/portal/documents/intosai/general/limaundmexikodeclaration/lima_declaration/). Parë në tetor 2011

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “*Raporti vjetor në Parlament për vitin, 2009.*”

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “*Raporti vjetor në Parlament për vitin 2010.*”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “*Letër zyrtare nga KMD për IDM.*”, datë 13. 10. 2011.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, “*Raport vjetor për aktivitetin e KLSH në Kuvend për vitin 2009.*”

Kontrolli i Lartë i Shtetit, “*Raport vjetor për aktivitetin e KLSH në Kuvend për vitin 2010.*”

Konferenca Kombëtare për prezantimin e studimit “*Vlerësim i rolit të IPM në reformën e sektorit të Sigurisë në Shqipëri.*” Tiranë, 8 nëntor 2011

Kuvendi i Shqipërisë, “*Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e punës së AP për vitin 2004.*” [http://www.avokatipopullit.gov.al/?page\\_id=259](http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259). Parë në gusht 2011



Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e punës së AP për vitin 2005.” [http://www.avokatipopullit.gov.al/?page\\_id=259](http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259). Parë në gusht 2011

Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e punës së AP për vitin 2006.” [http://www.avokatipopullit.gov.al/?page\\_id=259](http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259). Parë në gusht 2011

Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e aktivitetit të AP për vitin 2007.” [http://www.avokatipopullit.gov.al/?page\\_id=259](http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259). Parë në gusht 2011

Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e punës së AP për vitin 2008.” [http://www.avokatipopullit.gov.al/?page\\_id=259](http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259). Parë në gusht 2011

Kuvendi i Shqipërisë, “Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e punës së AP për vitin 2010.” [http://www.avokatipopullit.gov.al/?page\\_id=259](http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=259). Parë në gusht 2011

Organizata e Institucioneve të Kontrollit të Lartë. <http://www.intosai.org/>. Parë në gusht 2011

Organizata Evropiane e Institucioneve të Kontrollit të Lartë.  
[www.eurosai.org/International](http://www.eurosai.org/International). Parë në tetor 2011

Raport nga Komisioner për të Drejtat e Njeriut Z. Thomas Hammarberg, mbi vizitën e tij në Shqipëri, CommDH(2008)8 18 qershor 2008.  
<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1327977&Site=CommDH&BackColorInternet=FE65B&BackColorIntranet=FE65B&BackColorLogged=FFC679>. Parë në gusht 2011

## **Burime Dytësore**

Avokati i Popullit, “Avokati i Popullit në Shqipëri, 2003.”  
<http://www.avokatipopullit.gov.al/Raporte/AP.pdf>. Parë në tetor 2011

Avokati i Popullit, “Rekomandime të Avokatit të Popullit për Kryeministrin dhe Ministrin e Drejtësisë të datës 3 maj 2007 mbi përgatitjen e projekt-ligjit për themelimin e një autoriteti mbikëqyrës të pa varur përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri.”,  
<http://www.avokatipopullit.gov.al/Korrespondenca/Korr%2022052009.htm>, Parë në gusht 2011

Casals and Associates dhe Claro Associates. “Shqipëria: Raport mbi arritjet dhe draft vlerësim kapacitetesh.”, 2010.  
<http://www.oecd.org/dataoecd/55/48/47126088.pdf>. Parë në tetor 2011.

DIFID, “*Understanding and Supporting Security Sector Reform.*”  
[http://www.ssrnetwork.net/uploaded\\_files/4033.pdf](http://www.ssrnetwork.net/uploaded_files/4033.pdf). Parë në tetor 2011

Faqja zyrtare e internetit e KLSH, <http://www.klsh.org.al/mat.php?idm=80&l=a>. Parë në Shtator 2011

Faqja e internetit e ILKDP, “*Çështje korruptive prej 4 milionë Eurosh. Në Shqipëri gjobiten me 2000 Dollarë.*” <http://www.hidaa.gov.al/11-qershor-2011>, Parë në tetor 2011.

Fondacioni për një Shoqëri të Hapur në Shqipëri, “*Analiza dhe Rekomandime për Planveprimin për Adresimin e 12 rekomandimeve të opinionit të KE.*”, 22 prill 2011.  
[http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/OSFA%20-%20Analysis%20of%20Action%20Plan%20-%202012%20EC%20Recommendations%20-%20april%202011\\_EN.pdf](http://www.soros.al/2010/foto/uploads/File/OSFA%20-%20Analysis%20of%20Action%20Plan%20-%202012%20EC%20Recommendations%20-%20april%202011_EN.pdf). Parë në shtator 2011.

Human Rights Watch, “*Raporti për Shqipërinë, 1996.*” [www.hrw.org](http://www.hrw.org). Parë në tetor 2011

Human Rights Watch, “*Raporti për Shqipërinë, 1997.*” [www.hrw.org](http://www.hrw.org) Parë në tetor 2011

Gjipali, Gledis, “*Shqipëria: Shtetet në tranzicion 2011.*”, 2011 Freedom House, 65.  
<http://www.freedomhouse.org/images/File/nit/2011/NIT-2011-Albania.pdf>. Parë në tetor 2011

IDRA. “*Korrupsioni në Shqipëri. Perceptione dhe eksperiencia, Pyetësor për vitin 2010.*”

Këshilli i Evropës, “*Protokoll Shtesë i Konventës për Mbrojtjen e Individëve lidhur me Procedimin Automatik të të Dhënave Personale lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe shkëmbimet e informacionit ndër-kufitare.*”, Nëntor 2001; Strasburg.  
<http://www.garanteprivacy.it/garante/document?ID=1798198>. Parë në tetor 2011.

Këshilli i Bashkimit Evropian, “*Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe vendeve të tyre anëtarë dhe Republikës së Shqipërisë.*”, 22 maj 2006; Bruksel [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf). Parë në tetor 2011

Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “*Raport analitik që shoqëron Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Opinion i Komisionit për Aplikimin për Anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë.*”, nëntor, 2009  
[http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargement/47f\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargement/47f_en.htm). Parë në shtator 2011

Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “Raport analitik që shoqëron Komunikatën nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Opinion i Komisionit për Aplikimin për Anëtarësim në Bashkimin Evropian të Shqipërisë.”, nëntor, 2010 Seminar për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e policisë, 7 tetor 2011, <http://www.kmdp.al/>. Parë në tetor 2011

Komisioni i Komuniteteve Evropiane, “Progres Raporti i Shqipërisë për vitin 2010. Shoqërues i dokumentit komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2011-2012.”, tetor 2011, Bruksel, [http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargment/47f\\_en.htm](http://ec.europa.eu/europeaid/infopoint/publications/enlargment/47f_en.htm). Parë në shtator 2011

PACA, “Studim teknik. Përmbledhje e përfundimeve të takimit ndërmjet ekipit të PACAs dhe Inspektoratit të Lartë për Kontrollin dhe Deklarimin e Pasurive në lidhje me komentet dhe ndryshimet e ligjit për konfliktin e interesit dhe atë për deklarimin e pasurive.”, 2010. <http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/projects/Albania/Technical%20Papers/1917-PACA-TP34-HIDDA-CoI.pdf>. Parë në tetor 2011

Qendra për Zhvillim dhe Demokratizimin e Institucioneve, “Monitorimi i punës së Avokatit të Prokurimeve”. Raporti përfundimtar, mars 2011. [http://albania.usaid.gov/skedaret/1304066543-ProcurementAdvocate\\_En.pdf](http://albania.usaid.gov/skedaret/1304066543-ProcurementAdvocate_En.pdf), Parë për herë të fundit në Shtator 2011.

SIDA, “Studim anti-korrupsion për Shqipërinë.”, (2008) <http://www.aidharmonisation.org.al/skedaret/1203101753-SIDA%20Albania%20Anti-Corruption%20Study%20-%20Revised.pdf>. Parë në tetor 2011

SIGMA, “Vlerësim i Auditit të Jashtëm në Shqipëri.” Maj 2009, <http://www.oecd.org/dataoecd/0/56/43910245.pdf>. Parë në shtator 2011

## Artikuj Gazetash

“Emrat e 152 zyrtarëve që do t’ju verifikohen pasuritë.” *Gazeta Albania*, 28 maj 2009. <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/47555/titulli/Ja-emrat-e-152-zyrtareve-qe-do-tu-verifikohen-pasurite>. Parë në tetor 2011

Rama, A. “Sollaku: Shqipëria, të njëjtin numër përgjimesh si ShBA.” *Gazeta Shekulli*, 13 Mars 2007. <http://www.shekulli.com.al/neës/45/ARTICLE/6270/2007-03-13.html>. Parë në janar 2011.

Sulçe, Shaban. “166 zyrtarët që do të hetohen plotësisht nga ILKDP.”, *Gazeta Albania*, 30 prill 2009. <http://www.gazeta-albania.net/neës.php?id=16092>. Parë në tetor 2011.

“Spahiu: Ndryshime në ligjin për përgjimet.” *Gazeta Koha Jonë*, 14 shkurt 2009.  
[http://www.kohajone.com/html/artikull\\_37663.html](http://www.kohajone.com/html/artikull_37663.html). Parë në janar 2011